

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012“Për Peshkimin”, të ndryshuar
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Zhvillim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Procesi i përafrimit të legjislacionit me BE
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Përafrim i pjesshëm me Rregulloren (BE) 2023/2842
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	1. VKM Nr. 460, datë 29.6.2022 “Për miratimin e Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027” 2. VKM Nr. 88, datë 22.2.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030” 3. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit (UNCLOS), miratuar me ligjin Nr. 9055/2003.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	25 Maj deri më 23 Qeshor 2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	28.8.2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 26.6.2026
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	[2025 –MBZHR- 4]
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Marko Kule e-mail-i: Marko.kulo @bujqesia.gov.al numri i telefonit: 06 Eneida Sokoli e-mail-i: Eneida.sokoli@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 06 Adra Gjongecaj e-mail-i: Adra.gjongecaj@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 06

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
(Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Kuadri ligjor aktual në fuqi, i cili rregullon sektorin e peshkimit në Republikën e Shqipërisë dhe mbështetet kryesisht në ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar, nuk reflekton në mënyrë të plotë dhe të përditësuar zhvillimet më të fundit të acquis të Bashkimit Evropian, veçanërisht në fushën e kontrollit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së aktivitetit të peshkimit. Megjithëse gjatë viteve të fundit janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis, përfshirë edhe ndryshimet e realizuara gjatë vitit 2024, këto ndërhyrje kanë mbetur të pjesshme dhe nuk kanë arritur të integrojnë në mënyrë të plotë standardet dhe kërkesat e reja të kuadrit evropian.

Gjatë procesit të screening bilateral për Kapitullin 13 “Peshkimi”, të zhvilluar në shtator 2023, si dhe gjatë vijimësisë së dialogut teknik me Komisionin Evropian, u evidentuan një sërë mangësish në legjislacionin kombëtar, si në planin normativ ashtu edhe në atë institucional. Këto mangësi lidhen drejtpërdrejt me mungesën e një sistemi të integruar dhe plotësisht të digjitalizuar për monitorimin dhe kontrollin e aktivitetit të peshkimit, me përdorimin e kufizuar të teknologjive moderne për mbledhjen, përpunimin dhe shkëmbimin e të dhënave, si dhe me nevojën për harmonizim të plotë të dispozitave dhe terminologjisë kombëtare me rregulloret përkatëse të Bashkimit Evropian. Në këtë kontekst, është konstatuar se një pjesë e konsiderueshme e problematikave të evidentuara mund të adresohen vetëm nëpërmjet ndërhyrjeve ligjore.

Një problematikë tjetër e evidentuar është mospërputhja e disa dispozitave ekzistuese me standardet e acquis të Bashkimit Evropian, çka imponon domosdoshmërinë për ndryshime ligjore me qëllim garantimin e përputhshmërisë së plotë me acquis dhe sigurimin e zbatueshmërisë efektive të dispozitave. Këto mospërputhje ndikojnë drejtpërdrejt në eficiencën e instrumenteve të kontrollit dhe në garantimin e një zbatimi të njëtrajtshëm të legjislacionit. Në këtë drejtim paraqitet nevoja për rishikimin e dispozitave që lidhen me menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit ujor dhe gjallesave të tij, autorizimin për peshkim, transbordimin në det, përgjegjësinë civile, si dhe elementë të tjerë të sistemit të kontrollit dhe monitorimit, duke siguruar qartësi juridike dhe njëkohësisht përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian.

Nga ana tjetër, sistemi aktual i monitorimit të aktivitetit të peshkimit paraqet kufizime të dukshme në aspektin e përdorimit të sistemeve elektronike dhe transmetimit në kohë reale të të dhënave mbi aktivitetin e flotës së peshkimit. Mungesa e një baze të qartë ligjore për implementimin dhe përdorimin e sistemeve të tilla si Sistemi i Monitorimit të Anijeve (VMS), Sistemi i Monitorimit Elektronik në Distançë (REM) dhe Sistemi Automatik i Identifikimit (AIS), kufizon ndjeshëm kapacitetin e autoriteteve përgjegjëse për të ushtruar mbikëqyrje efektive dhe të vazhdueshme mbi aktivitetin në det dhe përgjatë zinxhirit të tregtimit.

Gjithashtu, kuadri ligjor aktual nuk parashikon në mënyrë të plotë bazën juridike për funksionimin e një strukture qendrore të dedikuar për monitorimin e aktivitetit të peshkimit dhe për koordinimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Mungesa e një baze të qartë ligjore për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Monitorimit të Peshkimit, si dhe për transmetimin dhe administrimin elektronik të të

dhënave, kufizon eficiencën e sistemit aktual të kontrollit dhe monitorimit dhe ndikon në aftësinë e autoriteteve për të garantuar zbatimin efektiv të legjislacionit në fuqi.

Problematikat e evidentuara reflektohen gjithashtu në efektivitetin e kufizuar të mekanizmave për parandalimin dhe luftën kundër peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP). Në mungesë të një sistemi të integruar kontrolli dhe të një rrjedhe të automatizuar dhe të sigurt të informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse, krijohen hapësira për praktika të papajtueshme me legjislacionin në fuqi, duke cënuar menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve biologjike detare, integritetin e tregut dhe besueshmërinë e produkteve shqiptare të peshkimit në tregjet ndërkombëtare.

Për shkaqet e përmendura më sipër, paraqitet nevoja për ndërhyrje në kuadrin rregullator në fuqi, me qëllim realizimin e përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian dhe adresimin e problematikave të evidentuara. Përditësimi dhe rishikimi i kuadrit ligjor në nivel ligji është i nevojshëm për të krijuar bazën juridike për zhvillimin e një sistemi modern, të integruar dhe të digjitalizuar të kontrollit dhe monitorimit të sektorit të peshkimit, për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe për garantimin e një përputhshmërie të plotë dhe të qëndrueshme me acquis të Bashkimit Evropian.

Propozimi i kësaj politike përbën një hap të rëndësishëm drejt avancimit të procesit të negociatave në kuadër të Kapitullit 13 “Peshkimi” dhe përmbushjes së objektivit strategjik të vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Projektligji sjell si risi kryesore krijimin dhe funksionalizimin e Qendrës së Monitorimit të Peshkimit (QMP), vendosjen e Sistemit të Monitorimit Elektronik në Distançë (REM) me përdorimin e kamerave dhe sensorëve në bord të anijeve, zgjerimin e përdorimit të Sistemit të Monitorimit të Anijeve (VMS), detyrimin për pajisjen e kategorive të caktuara të anijeve me Sistemin Automatik të Identifikimit (AIS), kalimin nga dokumentacioni në letër tek libri elektronik i peshkimit, deklaratat elektronike të zbarkimit dhe transbordimit, transmetimin elektronik të të dhënave në kohë reale drejt autoriteteve kompetente, forcimin e gjurmueshmërisë së produkteve të peshkimit përgjatë gjithë zinxhirit të furnizimit, si dhe shpërblimin e anëtarëve të komisioneve të përhershme që shqyrtojnë lejet dhe kërkesat në sektorin e peshkimit.

Grupet e identifikuar që ndikohen drejtpërdrejt nga ky projekligj janë:

1. Subjektet që ushtrojnë aktivitetet peshkimi tregtar
2. Peshkatarët dhe operatorët që ushtrojnë peshkim pa mjete lundruese
3. Subjektet e zinxhirit të tregtimit të produkteve të peshkimit
4. Institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e sektorit të peshkimit.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

1. Të sigurohet, brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, pwr përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e kontrollit dhe monitorimit të peshkimit.
2. Të krijohet dhe të bëhet funksionale, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, Qendra e Monitorimit të Peshkimit (QMP), e pajisur me infrastrukturën teknologjike dhe personelin e nevojshëm për monitorimin e vazhdueshëm të aktivitetit të peshkimit 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë.

3. Të sigurohet, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, pajisja me sisteme monitorimi elektronik të të gjitha kategorive të anijeve të peshkimit për të cilat ligji parashikon detyrim instalimi brenda kësaj periudhe, si dhe transmetimi elektronik i të dhënave të monitorimit në QMP.

4. Të rritet, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, shkalla e raportimit dhe monitorimit elektronik të aktivitetit të peshkimit, duke siguruar që deklaratat e zbarkimit, transbordimit dhe të dhënat e librit të peshkimit të transmetohen elektronikisht në QMP në përputhje me kërkesat e ligjit.

5. Të përmirësohet, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, efektiviteti i kontrollit të aktivitetit të peshkimit nëpërmjet vendosjes në funksion të mekanizmave të shkëmbimit elektronik të informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe përdorimit të sistemeve VMS, REM dhe AIS për mbikëqyrjen e aktivitetit të flotës së peshkimit.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e objektivave të politikës janë shqyrtuar opsionet e mëposhtme:

Opsioni 1: Mosndërhyrja (status quo): Ky opsion konsiston në ruajtjen e kuadrit ekzistues ligjor dhe institucional pa ndërmarrjen e ndryshimeve në ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar. Avantazhet e këtij opsioni lidhen me mungesën e kostove të menjëhershme ligjore dhe administrative që do të shoqëronin procesin e ndryshimeve ligjore dhe zbatimin e tyre. Megjithatë, ky opsion nuk është konsideruar i përshtatshëm, pasi nuk adreson problematikat e evidentuara gjatë procesit të screening bilateral dhe dialogut teknik me Komisionin Evropian. Ruajtja e status quo-së do të vijonte të linte të paadresuara mospërputhjet ekzistuese me acquis të Bashkimit Evropian, mungesën e bazës ligjore për sistemet moderne të monitorimit elektronik, kufizimet në shkëmbimin e të dhënave dhe dobësitë e mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit. Gjithashtu, ky opsion do të ndikonte negativisht në procesin e mëtejshëm të integritetit evropian dhe në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Kapitulli 13 “Peshkimi”. Për këto arsye, opsioni i mosndërhyrjes nuk është zgjedhur.

Opsioni 2: Ndërhyrja vetëm nëpërmjet akteve nënligjore dhe masave administrative. Ky opsion konsiston në adresimin e problematikave të identifikuara nëpërmjet miratimit ose përditësimit të akteve nënligjore dhe përmirësimeve administrative, pa ndërhyrë në nivel ligji. Avantazhet e këtij opsioni lidhen me fleksibilitetin procedural dhe kohën më të shkurtër të miratimit të akteve nënligjore, si dhe me kostot më të ulëta administrative në afat të shkurtër. Megjithatë, ky opsion nuk është konsideruar i mjaftueshëm, pasi një pjesë e konsiderueshme e problematikave të evidentuara lidhen me mungesën ose papërshtatshmërinë e dispozitave të nivelit ligjor. Çështje të tilla si krijimi dhe funksionimi i Qendrës së Monitorimit të Peshkimit, përdorimi i sistemeve VMS, REM dhe AIS, rregullimi i autorizimeve për peshkim, transmetimi elektronik i të dhënave, si dhe riformulimi i kundërvajtjeve dhe masave administrative kërkojnë domosdoshmërisht ndërhyrje në nivel ligji. Për më tepër, aktet nënligjore nuk mund të tejkalojnë kufijtë e delegimit ligjor dhe nuk mund të krijojnë kompetenca apo detyrime të reja pa bazë të qartë

ligjore. Për këto arsye, ky opsion nuk është zgjedhur. Ky ndryshim nuk përfshin kosto shtesë për buxhetin e shtetit, pasi zbatimi i ligjit do të mbështetet në strukturat ekzistuese administrative, të cilat tashmë janë në proces riorganizimi dhe modernizimi.

Opsioni 3: Ndryshimi i kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012 ‘Për peshkimin’, të ndryshuar” (opsioni i preferuar). Ky opsion konsiston në ndërhyrjen në nivel ligji me qëllim përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe krijimin e bazës së nevojshme ligjore për modernizimin e sistemit të kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit.

Avantazhet kryesore të këtij opsioni lidhen me:

- garantimin e përputhshmërisë së plotë të kuadrit ligjor kombëtar me *acquis* të Bashkimit Evropian;
- krijimin e bazës ligjore për funksionimin e Qendrës së Monitorimit të Peshkimit dhe për përdorimin e sistemeve moderne të monitorimit elektronik;
- përmirësimin e gjurmueshmërisë dhe transparencës së sektorit;
- forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe luftës kundër peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP);
- rritjen e sigurisë juridike dhe qartësimin e kompetencave institucionale;
- përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian.

Ky opsion është zgjedhur si opsioni i preferuar, pasi është i vetmi që adreson në mënyrë të plotë problematikat e identifikuar, garanton përputhshmërinë e qëndrueshme me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe krijon bazën juridike të nevojshme për zhvillimin e një sistemi modern, të integruar dhe efektiv të kontrollit dhe monitorimit të sektorit të peshkimit.

Opsioni 3: Ndërhyrja jorregullatore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve administrative dhe përmirësimit të praktikave ekzistuese. Ky opsion konsiston në ruajtjen e kuadrit aktual ligjor, duke synuar adresimin e problematikave të identifikuar nëpërmjet forcimit të kapaciteteve administrative dhe institucionale, rritjes së koordinimit ndërinstitutional, përmirësimit të praktikave administrative, trajnimit të stafit, si dhe optimizimit të proceseve ekzistuese të monitorimit dhe kontrollit. Avantazhet kryesore të këtij opsioni lidhen me shmangien e kostove që lidhen me ndryshimet ligjore, fleksibilitetin më të madh administrativ dhe mundësinë e përmirësimit të menjëhershëm të disa proceseve të punës në nivel institucional. Megjithatë, ky opsion nuk është konsideruar i mjaftueshëm, pasi problematikat e evidentuara nuk lidhen vetëm me kapacitetet administrative apo praktikat institucionale, por kryesisht me mungesën ose papërshtatshmërinë e bazës ligjore ekzistuese. Forcimi i administratës dhe përmirësimi i praktikave aktuale nuk mund të sigurojnë përafrimin e nevojshëm me *acquis* të Bashkimit Evropian, nuk mund të krijojnë bazën ligjore për funksionimin e Qendrës së Monitorimit të Peshkimit (QMP), për përdorimin e sistemeve VMS, REM dhe AIS, si dhe për transmetimin elektronik të të dhënave dhe rregullimin e detyrimeve të reja ligjore. Për më tepër, ky opsion nuk garanton adresimin e plotë të rekomandimeve të dala nga procesi i screening bilateral për Kapitullin 13 “Peshkimi” dhe nuk siguron përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit evropian. Për këto arsye, opsioni jorregullator nuk është zgjedhur.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike

Opsioni i preferuar pritet të ketë ndikime ekonomike pozitive, si në mënyrë të drejtpërdrejtë ashtu edhe në mënyrë të tërthortë. Ndikimet e drejtpërdrejta lidhen me përmirësimin e sistemit të kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit, rritjen e gjurmueshmërisë së produkteve të peshkimit dhe forcimin e transparencës përgjatë zinxhirit të tregtimit. Këto masa pritet të kontribuojnë në rritjen e besueshmërisë së produkteve shqiptare në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në përmirësimin e kushteve të konkurrencës në sektor. Ndikimet e tërthorta lidhen me përmirësimin e klimës së biznesit në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës, reduktimin e praktikave të peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP), si dhe krijimin e kushteve për zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik të sektorit në afat të gjatë.

Ndikimi mjedisor

Opsioni i preferuar pritet të ketë ndikime pozitive mjedisore. Ndikimet e drejtpërdrejta lidhen me forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit, përdorimin e sistemeve moderne të monitorimit elektronik dhe përmirësimin e zbatimit të masave për konservimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve biologjike detare. Këto masa pritet të kontribuojnë në reduktimin e peshkimit të paligjshëm dhe në mbrojtjen më efektive të ekosistemeve detare.

Ndikimet e tërthorta lidhen me ruajtjen afatgjatë të biodiversitetit detar, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore dhe përmirësimin e gjendjes së mjedisit detar në përputhje me standardet dhe politikat e Bashkimit Evropian.

Ndikimi social

Opsioni i preferuar pritet të ketë ndikime sociale pozitive. Ndikimet e drejtpërdrejta lidhen me rritjen e sigurisë juridike për subjektet që ushtrojnë aktivitet në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës, qartësimin e detyrimeve dhe përgjegjësisë të tyre, si dhe rritjen e transparencës dhe besueshmërisë në ushtrimin e aktivitetit ekonomik.

Ndikimet e tërthorta lidhen me forcimin e besimit të konsumatorëve ndaj produkteve të peshkimit, mbështetjen e komuniteteve që varen ekonomikisht nga sektori i peshkimit dhe promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore në interes të brezave të ardhshëm.

Ndikimet Kryesore të Projektligjit:

Projektligji ndikon në mënyra të ndryshme mbi këto grupe:

1. Qeveria: o Përmesh qëllimet e saj për përafrimin e legjislacionit kombëtar të peshkimit me acquis të Bashkimit Evropian dhe detyrimet që burojnë nga Kapitulli 13 "Peshkimi". o Përfshon kuadrin rregullator dhe institucional në fushën e monitorimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes së aktivitetit të peshkimit. o Modernizon sistemin kombëtar të kontrollit të peshkimit nëpërmjet digjitalizimit të proceseve të monitorimit, raportimit dhe gjurmueshmërisë. o Përmirëson kapacitetet administrative dhe rrit eficiencën e institucioneve përgjegjëse për kontrollin dhe luftën kundër peshkimit të paligjshëm.

2. Subjektet që ushtrojnë aktivitete peshkimi tregtar (operatorë me anije peshkuese, pronarë anijesh, kapitenë dhe ekuipazhe): o Duhet të përmbushin kërkesa të reja ligjore dhe teknike lidhur me monitorimin elektronik, raportimin dhe transmetimin e të dhënave. o Përballen me kosto fillestare për instalimin dhe përdorimin e sistemeve të reja të monitorimit elektronik. o Përfitojnë nga rritja e transparencës, standardizimi i procedurave dhe rritja e besueshmërisë së produkteve të tyre në treg.
3. Peshkatarët, përfshirë personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë peshkim pa mjete lundruese: o Përfshihen për herë të parë në një sistem të formalizuar regjistrimi dhe monitorimi të aktivitetit të tyre. o Përfitojnë nga qartësimi i statusit të tyre ligjor dhe krijimi i mekanizmave të posaçëm të regjistrimit dhe raportimit. o Rriten mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm të aktivitetit dhe akses më të mirë në politikat mbështetëse të sektorit.
4. Subjektet që kryejnë zbarkimin, peshimin dhe tregtimin fillestar të produkteve të peshkimit (blerës të regjistruar, ankande, organizata prodhuesish dhe subjekte të autorizuar për peshimin e produkteve të peshkimit): o Përballen me detyrime të reja për raportimin, regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave lidhur me aktivitetin e tyre. o Përfitojnë nga përmirësimi i sistemit të gjurmueshmërisë dhe rritja e besueshmërisë së produkteve të peshkimit. o Përmirësojnë standardet e tregtimit dhe rrisin mundësitë për akses në tregjet europiane dhe ndërkombëtare.
5. Subjektet e akuakulturës: o Përfitojnë nga forcimi i sistemit të monitorimit dhe mbledhjes së të dhënave në sektor. o Rritet siguria juridike dhe përmirësohen kushtet për zhvillimin e qëndrueshëm të aktivitetit. o Përfitojnë nga harmonizimi i legjislacionit kombëtar me standardet e Bashkimit Evropian.
6. Institucionet shtetërore të përfshira në monitorimin dhe kontrollin e aktivitetit të peshkimit: o Përfitojnë nga qartësimi dhe forcimi i kompetencave institucionale në fushën e monitorimit dhe kontrollit të aktivitetit të peshkimit. o Përmirësojnë shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin ndërinstitucional nëpërmjet sistemeve elektronike të monitorimit dhe raportimit. o Rritin eficiencën e mekanizmave të kontrollit dhe të luftës kundër peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar.

Kosto dhe Përfitime:

- Kosto të Sektorit Privat: Nuk identifikohen kosto të reja të konsiderueshme për sektorin privat, pasi projektligji synon kryesisht përmirësimin dhe digjitalizimin e proceseve ekzistuese të monitorimit, kontrollit dhe raportimit në sektorin e peshkimit. Megjithatë, operatorët ekonomikë mund të përballen me kosto fillestare të kufizuara për përshtatjen me kërkesat e reja teknike dhe procedurale që lidhen me përdorimin e sistemeve elektronike të monitorimit dhe raportimit.
- Përfitime të Sektorit Privat: Përmirësimi i sistemit të monitorimit, kontrollit dhe gjurmueshmërisë pritet të rrisë besueshmërinë dhe konkurrueshmërinë e produkteve shqiptare të peshkimit në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, harmonizimi i legjislacionit me acquis të Bashkimit Evropian krijon kushte më të favorshme për akses në tregjet europiane dhe zhvillimin e qëndrueshëm të aktivitetit ekonomik në sektor.
- Kosto të Sektorit Publik: Zbatimi i projektligjit shoqërohet me një kosto të drejtpërdrejtë vjetore prej 2,8 milionë lekësh. Nga kjo vlerë, 2 milionë lekë lidhen me krijimin e pozicionit të ri të përgjegjës të Qendrës së Monitorimit të Peshkimit (QMP) dhe do të përballohen brenda fondit ekzistues të pagave të DSHPA-së, pa kërkuar rritje

të tavanit buxhetor. Vlera prej 0,8 milionë lekësh lidhet me shpërblimin e anëtarëve të dy komisioneve, përkatësisht 0,6 milionë lekë për Komisionin e Përhershëm të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit dhe 0,2 milionë lekë për Komisionin për Shqyrtimin e Ankimeve, dhe do të planifikohet në PBA-në përkatëse. Gjithashtu, instalimi dhe integrimi i 35 pajisjeve VMS për anijet me gjatësi nga 9 deri në 11,99 metra ka një kosto të njëhershme prej 3,848 milionë lekësh, e cila do të mbështetet nga projekti përkatës. Kostot për shtrirjen e sistemit VMS tek anijet me gjatësi më të vogël se 9 metra dhe për zbatimin e plotë të sistemit REM do të përcaktohen pas përfundimit të anketimit të flotës, studimit të tregut dhe studimit të fizibilitetit dhe do të përballohen brenda tavanëve të programit buxhetor 04230 “Mbështetje për Peshkimin”. Ndërkohë, për sistemin AIS nuk parashikohen kosto shtesë, pasi ai është ekzistues dhe funksional.

- Përfitime të Sektorit Publik: Përfitimet për sektorin publik konsistojnë në rritjen e eficiencës së sistemit të monitorimit dhe kontrollit të aktivitetit të peshkimit, përmirësimin e koordinimit ndër-institucional, forcimin e mekanizmave për luftën kundër peshkimit të paligjshëm, si dhe rritjen e kapaciteteve administrative për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian.

Në përfundim, projektligji pritet të ketë një ndikim të përgjithshëm pozitiv në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës, duke kontribuar në modernizimin e kuadrit ligjor dhe institucional, forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe kontrollit, si dhe rritjen e gjurmueshmërisë dhe transparencës në sektor. Megjithatë zbatimi i disa prej masave të reja mund të kërkojë përshtatje teknike dhe procedurale nga subjektet e prekura, përfitimet afatgjata pritet të jenë të konsiderueshme, veçanërisht në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit, rritjes së konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare të peshkimit dhe përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian. Në tërësi, projektligji krijon një bazë më të konsoliduar për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve biologjike detare dhe forcimin e kapaciteteve institucionale në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i preferuar është ndërhyrja rregullatore nëpërmjet miratimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012 ‘Për peshkimin’, të ndryshuar”. Ky opsion është zgjedhur pasi është i vetmi që adreson në mënyrë të plotë problematikat e evidentuara në kuadrin aktual ligjor dhe krijon bazën e nevojshme juridike për përafrimin e mëtijshëm të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit.

Zgjedhja e këtij opsioni lidhet drejtpërdrejt me nevojën për të reflektuar në legjislacionin kombëtar ndryshimet e sjella nga Rregullorja (BE) 2023/2842, e cila ka përditësuar sistemin evropian të kontrollit të peshkimit. Ndërhyrja në nivel ligji është e domosdoshme, pasi çështje të tilla si funksionimi i Qendrës së Monitorimit të Peshkimit, përdorimi i sistemeve moderne të monitorimit elektronik, transmetimi elektronik i të dhënave, gjurmueshmëria e produkteve të peshkimit dhe forcimi i mekanizmave kundër peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar nuk mund të rregullohen në mënyrë të plotë vetëm përmes masave administrative ose akteve nënligjore.

Opsioni i ndryshimit ligjor siguron qartësi juridike, përcakton më mirë kompetencat institucionale dhe krijon bazën ligjore për një sistem më të integruar, më transparent dhe më efektiv të kontrollit të sektorit të peshkimit. Nëpërmjet këtij opsioni mundësohet përdorimi

i sistemeve VMS, REM dhe AIS,¹ funksionimi i Qendrës së Monitorimit të Peshkimit, raportimi elektronik i të dhënave, si dhe përmirësimi i kontrollit mbi aktivitetet e zbarkimit, transbordimit, peshimit dhe tregtimit fillestar të produkteve të peshkimit.

Ky opsion është zgjedhur gjithashtu pasi kontribuon drejtpërdrejt në përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian, veçanërisht për Kapitullin 13 “Peshkimi”. Përmes tij rritet shkalla e përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian dhe forcohet kapaciteti i administratës për të zbatuar standardet evropiane në fushën e kontrollit, monitorimit, gjurmueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve biologjike detare.

Përfitimet kryesore të opsionit të preferuar janë përmirësimi i monitorimit të flotës së peshkimit, rritja e transparencës në sektor, rritja e besueshmërisë së të dhënave, forcimi i gjurmueshmërisë së produkteve të peshkimit, reduktimi i hapësirave për peshkim të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar, si dhe rritja e besueshmërisë së produkteve shqiptare në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto përfitime kanë kryesisht karakter cilësor dhe institucional dhe nuk janë të gjitha të shprehura në vlerë monetare të drejtpërdrejtë.

Sa i përket kostove, në përputhje me relacionin shoqërues të projektligjit, ky opsion nuk krijon efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Monitorimit të Peshkimit, pasi strukturat dhe funksionet përkatëse do të sigurohen brenda numrit aktual të miratuar të punonjësve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucioneve të saj të varësisë, nëpërmjet riorganizimit të institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës.

Gjithashtu, lidhur me komisionet e parashikuara në kuadrin ligjor, relacioni përcakton se masa e shpërblimit të anëtarëve të tyre do të jetë sipas legjislacionit në fuqi për shpërblimin e anëtarëve të këshillave, bordeve dhe komisioneve të përhershme. Për rrjedhojë, ndikimi financiar mbi buxhetin e shtetit mbetet i kufizuar dhe i lidhur me mekanizmat ekzistues buxhetorë, pa krijuar një barrë të re financiare të veçantë.

Për bizneset dhe subjektet që ushtrojnë aktivitet në sektorin e peshkimit mund të ketë kosto përshtatëse dhe administrative, të lidhura me përmbushjen e detyrimeve të reja për raportim elektronik, monitorim, transmetim të të dhënave dhe respektim të kërkesave të reja teknike. Megjithatë, këto kosto nuk janë të përcaktuara në vlerë monetare në këtë fazë dhe pritet të zbatohen në mënyrë graduale. Përfitimet afatgjata për bizneset vlerësohen më të mëdha se kostot fillestare, pasi një sistem më transparent dhe i gjurmueshëm rrit besueshmërinë e produkteve, ul konkurrencën e pandershme dhe forcon pozicionin e operatorëve të rregullt në treg.

Në përfundim, opsioni i ndryshimit ligjor është zgjedhur si opsioni më i përshtatshëm, pasi garanton përputhshmëri me acquis të Bashkimit Evropian, forcon sigurinë juridike, krijon bazën për modernizimin e sistemit të kontrollit dhe monitorimit të peshkimit, nuk krijon efekte financiare shtesë të drejtpërdrejta në buxhetin e shtetit për funksionimin e QMP-së dhe sjell përfitime të rëndësishme institucionale, ekonomike, mjedisore dhe sociale.

¹ VMS (Vessel Monitoring System) – Sistemi i Monitorimit të Anijeve; REM (Remote Electronic Monitoring) – Sistemi i Monitorimit Elektronik në Distançë; AIS (Automatic Identification System) – Sistemi Automatik i Identifikimit.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
0	2,8	2,8

Nga zbatimi i projektligjit, efekti financiar shtesë, i drejtpërdrejtë dhe i kuantifikueshëm në këtë fazë për buxhetin e shtetit lidhet me shpërblimin e anëtarëve të Komisionit të Përhershëm të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit dhe të Komisionit për Shqyrtimin e Ankimimeve të cilat vijojnë pas miratimit të ligjit dhe akteve nënligjore.

Anëtarët e këtyre komisioneve janë pjesë e stafit ekzistues të Ministrisë dhe institucioneve të saj të varësisë, ndërsa angazhimi në komisione realizohet paralelisht me detyrat e tyre të zakonshme funksionale. Ky angazhim përfshin shqyrtimin e dokumentacionit administrativ dhe teknik, verifikimin e përmbushjes së kriterëve ligjore, përgatitjen e materialeve dhe procesverbaleve, pjesëmarrjen në mbledhje dhe marrjen e vendimeve kolegjiale që prodhojnë pasoja juridike për subjektet. Për rrjedhojë, pjesëmarrja në komisione përbën ngarkesë dhe përgjegjësi shtesë për stafin.

Efekti financiar vjetor për shpërblimin e anëtarëve të dy komisioneve përlllogaritet në **800 000 (tetëqind mijë) lekë**, nga të cilat 600 000 lekë për Komisionin e Përhershëm të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit dhe 200 000 lekë për Komisionin për Shqyrtimin e Ankimimeve. Kjo kosto do të planifikohet në PBA-në përkatëse, brenda programit buxhetor 04230 “Mbështetje për Peshkimin”, pas hyrjes në fuqi të ligjit dhe plotësimit të kuadrit nënligjor të nevojshëm.

Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Monitorimit të Peshkimit (QMP) nuk lind nevoja për shtesë fondi në buxhetin e shtetit. Funksionet e saj do të realizohen nëpërmjet riorganizimit të strukturës ekzistuese dhe përdorimit të pozicioneve aktuale të Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës. Efekti financiar i pozicionit të ri në nivel përgjegjësi sektori, i vlerësuar në rreth **2 000 000 lekë në vit**, do të përballohet brenda fondit ekzistues të pagave të DSHPA-së, pa kërkuar rritje të tavanit buxhetor. Në këto kushte, kjo kosto nuk krijon efekt financiar shtesë neto për buxhetin e shtetit.

Lidhur me investimet për sistemet elektronike të monitorimit, Ministria po mbështetet në fazën aktuale nga projekti pilot i Komisionit të Përgjithshëm për Peshkimin në Mesdhe (GFCM). Nëpërmjet këtij projekti do të testohet Sistemi i Monitorimit Elektronik në Distançë (REM), do të përcaktohen standardet dhe specifikimet teknike, do të vlerësohet mënyra e integritetit me sistemet ekzistuese dhe do të analizohet fizibiliteti teknik dhe financiar i zbatimit të plotë të tij.

Kostoja e plotë e sistemit REM nuk mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme në këtë fazë. Ende nuk janë përcaktuar konfigurimi teknik, numri i anijeve që do të përfshihen, pajisjet dhe programet e nevojshme, mënyra e transmetimit dhe ruajtjes së të dhënave, kostot e integritetit dhe mirëmbajtjes, si dhe fazat e zbatimit. Gjithashtu, nuk ekziston një model i vetëm evropian që mund të zbatohet drejtpërdrejt si bazë reference për karakteristikat dhe kushtet konkrete të flotës shqiptare.

Për rrjedhojë, kostoja e zbatimit të plotë të sistemit REM nuk është përfshirë në efektin financiar të kuantifikuar të projektligjit. Pas përfundimit të projektit pilot dhe studimit të fizibilitetit do të përcaktohen shtrirja e sistemit, fazat e implementimit dhe kostoja

përfundimtare. Efektet financiare që do të rezultojnë do të parashikohen në PBA-në përkatëse, brenda programit buxhetor 04230 “Mbështetje për Peshkimin”, përpara fillimit të zbatimit të plotë.

Në përfundim, efekti financiar shtesë neto, i drejtpërdrejtë dhe i identifikueshëm aktualisht për buxhetin e shtetit përlogaritet në **800 000 lekë në vit** dhe lidhet me shpërblimin e anëtarëve të dy komisioneve. Kostoja prej rreth **2 000 000 lekësh në vit** për pozicionin e ri të përgjegjësit të QMP-së përbën kosto të zbatimit të projektligjit, por do të përballohet brenda fondeve ekzistuese të DSHPA-së dhe nuk kërkon financim shtesë nga buxheti i shtetit.

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse.

Projektligji iu nënshtrua procesit të konsultimit publik nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, për një periudhë prej 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik.

Publikimi u bë në datë 25.5.2026 dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJKP, ku të gjitha palët e interesuara:

- organet publike;
- shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;
- personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe

- personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë,

ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektaktin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik. Data e mbylljes së procesit të konsultimit ishte 23.6.2026. Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 320 shikime në platformën online, por nuk janë regjistruar komente në RENJKP. Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar, ishin: Konsultimi elektronik përmes Regjistrit Elektronik, RENJK (25.5.2026 – 23.6.2026);

Projektligji është përgatitur nga grupi i punës ngritur me urdhrin e ministrit nr. 320, datë 26.3.2026. Projektligji është në përputhje me Programin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) dhe me angazhimet e marra në kuadër të procesit të integrimit evropian për Kapitullin 13 “Peshkimi”. Projektligji është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2030, si dhe me Strategjinë Ndërsektoriale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021–2027. Nuk rezulton të ketë patur palë të interesuara (organizata të shoqërisë civile, subjekte private apo individë), të përfshira në procesin e konsultimit publik të projektaktit. Nga procesi i konsultimit të projektligjit, nuk ka patur rekomandime lidhur me draftin e paraqitur.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi i projektligjit do të realizohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nëpërmjet institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës, strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e aktivitetit të peshkimit, si dhe Qendrës së Monitorimit të Peshkimit (QMP).

Zbatimi i projektligjit do të mbështetet në miratimin, brenda afateve të përcaktuara në ligj, të akteve nënligjore të nevojshme për operacionalizimin e dispozitave të reja, veçanërisht atyre që lidhen me sistemet elektronike të monitorimit dhe raportimit, funksionimin e Qendrës së Monitorimit të Peshkimit, procedurat e kontrollit, si dhe administrimin dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave.

Monitorimi i zbatimit të projektligjit do të realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet përgjegjëse nëpërmjet vlerësimit të funksionimit të sistemeve të monitorimit elektronik, nivelit të raportimit elektronik të të dhënave, shkallës së përmbushjes së detyrimeve nga subjektet e sektorit, si dhe efektivitetit të masave të kontrollit dhe luftës kundër peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP).

Gjithashtu, monitorimi do të mbështetet në analizën periodike të të dhënave të mbledhura nga sistemet elektronike të monitorimit, raportet e strukturave përgjegjëse për kontrollin dhe monitorimin e aktivitetit të peshkimit, si dhe në vlerësimin e progresit të arritur në drejtim të përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR): Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është institucioni kryesor përgjegjës për koordinimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të zbatimit të projektligjit. MBZHR do të jetë përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e dispozitave të reja ligjore, si dhe për monitorimin e progresit të arritur në drejtim të përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, ministria do të sigurojë koordinimin ndërinstitucional dhe do të monitorojë realizimin e objektivave të politikës në sektorin e peshkimit.

Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës (DSHPA): Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës do të jetë përgjegjës për zbatimin operacional të dispozitave të projektligjit. Ky institucion do të administrojë procedurat që lidhen me lejet dhe autorizimet e peshkimit, administrimin e të dhënave, monitorimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës, si dhe mbledhjen dhe përpunimin e informacionit të nevojshëm për zbatimin efektiv të legjislacionit. Gjithashtu, institucioni do të monitorojë respektimin e detyrimeve nga subjektet e sektorit dhe do të raportojë periodikisht pranë MBZHR mbi ecurinë e zbatimit të projektligjit.

Qendra e Monitorimit të Peshkimit (QMP): Qendra e Monitorimit të Peshkimit do të përbëjë strukturën qendrore përgjegjëse për monitorimin e flotës shqiptare të peshkimit dhe të anijeve të huaja të autorizuara për të operuar në ujërat shqiptare. QMP do të funksionojë në regjim të pandërprerë dhe do të monitorojë në kohë reale aktivitetin e anijeve peshkuese nëpërmjet sistemeve elektronike të monitorimit, përfshirë VMS, AIS dhe REM. Gjithashtu, QMP do të administrojë dhe analizojë të dhënat elektronike të transmetuara nga subjektet e peshkimit, duke kontribuar në forcimin e kontrollit, gjurmueshmërisë dhe luftës kundër peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP).

Strukturat inspektuese përgjegjëse për kontrollin e aktivitetit të peshkimit: Strukturat inspektuese që mbulojnë fushën e peshkimit do të jenë përgjegjëse për kontrollin dhe verifikimin në terren të zbatimit të dispozitave të projektligjit. Këto struktura do të kryejnë inspektime administrative dhe teknike, do të monitorojnë respektimin e kërkesave ligjore nga subjektet e sektorit dhe do të marrin masat administrative të parashikuara në rast të konstatimit të shkeljeve. Të dhënat dhe gjetjet e këtyre strukturave do të shërbejnë gjithashtu si bazë për monitorimin e efektivitetit të zbatimit të projektligjit.

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Sektori i peshkimit në Shqipëri ka përbërë tradicionalisht një aktivitet me rëndësi ekonomike dhe sociale, duke u mbështetur në burimet e konsiderueshme detare dhe ujërat e brendshme të vendit. Pozicioni gjeografik i Shqipërisë, me dalje në Detin Adriatik dhe Detin Jon, si dhe prania e liqeneve, lagunave dhe rezervuarëve të shumtë, kanë krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës. Në dekadat e fundit, sektori ka pësuar zhvillime të rëndësishme, veçanërisht në drejtim të rritjes së kapaciteteve të përpunimit, zhvillimit të akuakulturës dhe modernizimit gradual të flotës së peshkimit.

Pas viteve 1990, sektori i peshkimit, njësoj si sektorë të tjerë të ekonomisë shqiptare, kaloi një proces transformimi dhe ristrukturimi institucional. Në këtë periudhë u evidentua nevoja për krijimin e një kuadri të ri ligjor dhe institucional, i cili të garantonte menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve biologjike detare, zhvillimin e sektorit dhe përafrimin gradual me standardet ndërkombëtare dhe ato të Bashkimit Evropian.

Në këtë kuadër, u miratua ligji nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar, i cili krijoi bazën kryesore ligjore për rregullimin e sektorit të peshkimit dhe akuakulturës në Republikën e Shqipërisë dhe mundësoi fillimin e procesit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e peshkimit.

Megjithatë, zhvillimet e vazhdueshme të acquis të Bashkimit Evropian, ndryshimet në Politikën e Përbashkët të Peshkimit dhe nevoja për modernizimin e sistemit të kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit kanë krijuar nevojën për përditësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor kombëtar. Kjo nevojë u evidentua veçanërisht gjatë procesit të screening bilateral për Kapitullin 13 “Peshkimi”, si dhe gjatë dialogut teknik me Komisionin Evropian, ku u identifikuan një sërë mangësish që kërkojnë ndërhyrje në nivel ligji dhe në aktet nënligjore përkatëse.

Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve biologjike detare dhe zhvillimi i sektorit të peshkimit kanë përbërë ndër vite një ndër prioritetet e politikave publike në Republikën e Shqipërisë, për shkak të rëndësisë ekonomike, sociale dhe mjedisore që ky sektor paraqet. Sektori i peshkimit kontribuon në sigurimin e ushqimit, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin ekonomik të komuniteteve bregdetare dhe rurale, si dhe në ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore ujore.

Shqipëria, për shkak të pozicionit të saj gjeografik dhe pasurisë së konsiderueshme të ekosistemeve detare dhe ujërave të brendshme, ka krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit detar, peshkimit në ujërat e brendshme dhe akuakulturës. Zhvillimi progresiv i sektorit, rritja e numrit të operatorëve ekonomikë dhe zgjerimi i aktivitetit tregtar kanë sjellë nevojën për forcimin e vazhdueshëm të kuadrit ligjor dhe institucional që rregullon këtë sektor.

Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027 përcakton si objektiv të përgjithshëm nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të peshkimit detar dhe të ujërave të brendshme, në përputhje me Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm nr. 14 të Agjendës 2030

të Kombeve të Bashkuara, që synon ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të deteve dhe burimeve detare.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Natyra e problemit

Kuadri ligjor aktual në fuqi, i mbështetur kryesisht në ligjin nr. 64/2012 "Për peshkimin", të ndryshuar, nuk reflekton në mënyrë të plotë zhvillimet më të fundit të acquis të Bashkimit Evropian në fushën e kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit. Si rezultat, sistemi aktual paraqet mangësi në aspektin e monitorimit elektronik, raportimit dhe transmetimit të të dhënave, gjurmueshmërisë së produkteve të peshkimit, si dhe koordinimit institucional për kontrollin e aktivitetit të peshkimit.

Shkaqet e problemit

Nevoja për ndërhyrje ligjore ka lindur në kuadër të procesit të vazhdueshëm të përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e peshkimit, përfshirë ndryshimet e reflektuara në Rregulloren (BE) 2023/2842, e cila ka përditësuar sistemin evropian të kontrollit të peshkimit. Në këtë kontekst, është evidentuar nevoja për përditësimin e disa dispozitave të legjislacionit kombëtar dhe për krijimin e bazës së nevojshme ligjore për zbatimin e instrumenteve të reja të monitorimit dhe kontrollit. Gjithashtu, gjatë procesit të screening bilateral për Kapitullin 13 "Peshkimi" dhe dialogut teknik me Komisionin Evropian janë identifikuar disa çështje në nivel normativ dhe institucional, të cilat kërkojnë adresim përmes ndërhyrjeve përkatëse ligjore.

Shtrirja e problemit

Problemi shtrihet në të gjithë sektorin e peshkimit dhe akuakulturës, duke ndikuar në monitorimin e aktivitetit të peshkimit detar dhe të ujërave të brendshme, administrimin e flotës së peshkimit, raportimin dhe transmetimin e të dhënave, kontrollin e zbarkimeve dhe transbordimeve, gjurmueshmërinë e produkteve të peshkimit, si dhe luftën kundër peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP). Problematikat e evidentuara ndikojnë gjithashtu në procesin e integritetit evropian dhe në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të Kapitullit 13 "Peshkimi".

Grupet e prekura

Qeveria: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës, Qendra e Monitorimit të Peshkimit (QMP), strukturat inspektuese dhe institucionet e tjera shtetërore të përfshira në administrimin, monitorimin dhe kontrollin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës.

Biznesi: subjektet që ushtrojnë aktivitete peshkimi tregtar (operatorë me anije peshkuese, pronarë anijesh, kapitenë dhe ekuipazhe), subjektet e akuakulturës, peshkatarët që ushtrojnë aktivitete pa mjete lundruese, si dhe subjektet që kryejnë zbarkimin, peshimin dhe tregtimin fillestar të produkteve të peshkimit (blerës të regjistruar, ankande, organizata prodhuesish dhe subjekte të autorizuar për peshimin e produkteve të peshkimit).

Shoqëria civile: organizatat e shoqërisë civile, organizatat mjedisore dhe grupet e interesit që veprojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit detar, biodiversitetit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve biologjike ujore.

Qytetarët: konsumatorët e produkteve të peshkimit, komunitetet bregdetare dhe komunitetet e tjera që varen ekonomikisht ose socialisht nga sektori i peshkimit dhe akuakulturës.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme?

Qeveria planifikon të ndërhyjë për shkak se kuadri ligjor aktual në fushën e peshkimit nuk reflekton në mënyrë të plotë zhvillimet më të fundit të *acquis* të Bashkimit Evropian, veçanërisht në fushën e kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit. Gjatë procesit të screening bilateral për Kapitullin 13 “Peshkimi”, si dhe gjatë dialogut teknik me Komisionin Evropian, janë evidentuar mangësi në kuadrin normativ dhe institucional, të cilat kërkojnë ndërhyrje në nivel ligji.

Në këtë kuadër, ndryshimet e propozuara synojnë, ndër të tjera, krijimin e bazës ligjore për zbatimin e Sistemit të Monitorimit të Anijeve (VMS) për flotën artizanale, i cili mundëson gjurmimin dhe monitorimin në kohë reale të pozicionit dhe aktivitetit të mjeteve të peshkimit, si dhe të sistemit të Monitorimit Elektronik në Distançë (REM), i cili përdor kamera dhe pajisje të tjera elektronike për monitorimin e aktiviteteve të peshkimit në bord dhe rritjen e kontrollit të përputhshmërisë me rregullat e peshkimit.

Ndërhyrja është e nevojshme për të siguruar përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me *acquis* të Bashkimit Evropian, forcimin e sistemit të kontrollit dhe monitorimit të peshkimit, si dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian.

Qeveria planifikon të ndërhyjë pasi kuadri aktual ligjor në fushën e peshkimit nuk siguron një sistem kontrolli, monitorimi dhe gjurmueshmërie që i përgjigjet zhvillimeve teknologjike dhe standardeve të kërkuara nga sistemi evropian i kontrollit në fushën e peshkimit. Ndërkohë që ligji nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar, ka krijuar bazën për menaxhimin dhe kontrollin e aktivitetit të peshkimit, një pjesë e mekanizmave të parashikuar në të mbështeten ende në procedura administrative tradicionale, kontrole fizike dhe raportim të kufizuar elektronik, të cilat nuk garantojnë monitorim të vazhdueshëm dhe verifikim të plotë të aktivitetit të flotës së peshkimit. Sistemi aktual nuk mundëson përdorimin e plotë të mjeteve moderne të monitorimit dhe kontrollit që kërkojnë nga kuadri i përditësuar i Bashkimit Evropian, si monitorimi elektronik në distancë (REM), zgjerimi i sistemeve satelitore të monitorimit të mjeteve të peshkimit (VMS), raportimi dhe administrimi elektronik i të dhënave, si dhe shkëmbimi i integruar i informacionit ndërmjet institucioneve kompetente. Si rezultat, mbikëqyrja e

aktivitetit të peshkimit aktualisht në Shqipëri, mbështetet në kontrolle pas ndodhjes së faktit, duke kufizuar mundësinë për identifikimin në kohë reale të shkeljeve dhe për ndërhyrje të menjëhershme nga autoritetet përgjegjëse dhe duke eliminuar kështu mundësinë e parandalimit të tyre. Gjithashtu, kuadri ligjor aktual paraqet kufizime në garantimin e gjurmueshmërisë së plotë të produkteve të peshkimit përgjatë zinxhirit të furnizimit. Mungesa e instrumenteve të avancuara për regjistrimin, verifikimin dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave e bën më të vështirë identifikimin e origjinës së produkteve, verifikimin e ligjshmërisë së kapjeve dhe luftën kundër peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP), i cili përbën një nga objektivat kryesore të politikës së përbashkët të peshkimit të Bashkimit Evropian. Gjatë procesit *screening* bilateral për Kapitullin 13 “Peshkimi” dhe dialogut teknik me Komisionin Evropian janë identifikuar boshllëqe ligjore dhe institucionale në fushën e kontrollit, monitorimit, raportimit dhe gjurmueshmërisë, të cilat kërkojnë ndërhyrje në nivel ligji. Për këtë arsye, ndërhyrja vlerësohet e nevojshme jo vetëm për përmbushjen e detyrimeve të procesit të integritetit evropian, por edhe për të rritur efektivitetin e sistemit kombëtar të menaxhimit të peshkimit, për të siguruar mbrojtjen e burimeve peshkore dhe për të përmirësuar zbatimin e legjislacionit në sektor.

Si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë?

Kjo ndërhyrje mbështet objektivat strategjikë të qeverisë për integrimin evropian, zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të peshkimit dhe forcimin e kapaciteteve institucionale. Nisma kontribuon në realizimin e objektivave të Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027, e cila synon zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit dhe ruajtjen e burimeve biologjike detare, si dhe të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030, e cila synon avancimin e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, ndërhyrja kontribuon në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të Kapitullit 13 “Peshkimi”.

Puna ekzistuese e realizuar tashmë

Në kuadër të modernizimit të sektorit të peshkimit dhe procesit të integritetit evropian, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë reformash ligjore dhe institucionale, ndër të cilat miratimi dhe ndryshimi i ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar, si dhe përafrimi i pjesshëm i legjislacionit kombëtar me një numër rregulloresh të Bashkimit Evropian në fushën e peshkimit. Gjatë vitit 2024 janë realizuar ndryshime të mëtejshme në ligj për të rritur shkallën e përafrimit me *acquis*. Gjithashtu, janë zhvilluar procesi i *screening* bilateral për Kapitullin 13 “Peshkimi”, takime teknike dhe dialog i vazhdueshëm me Komisionin Evropian, në kuadër të të cilëve janë identifikuar nevojat për përditësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe institucional në sektor.

Objekti i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

1. Të sigurohet, brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, pwr përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e kontrollit dhe monitorimit të peshkimit.

2. Të krijohet dhe të bëhet funksionale, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, Qendra e Monitorimit të Peshkimit (QMP), e pajisur me infrastrukturën teknologjike dhe

personelin e nevojshëm për monitorimin e vazhdueshëm të aktivitetit të peshkimit 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë.

3. Të sigurohet, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, pajisja me sisteme monitorimi elektronik të të gjitha kategorive të anijeve të peshkimit për të cilat ligji parashikon detyrim instalimi brenda kësaj periudhe, si dhe transmetimi elektronik i të dhënave të monitorimit në QMP.

4. Të rritet, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, shkalla e raportimit dhe monitorimit elektronik të aktivitetit të peshkimit, duke siguruar që deklaratat e zbarkimit, transbordimit dhe të dhënat e librit të peshkimit të transmetohen elektronikisht në QMP në përputhje me kërkesat e ligjit.

5. Të përmirësohet, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, efektiviteti i kontrollit të aktivitetit të peshkimit nëpërmjet vendosjes në funksion të mekanizmave të shkëmbimit elektronik të informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe përdorimit të sistemeve VMS, REM dhe AIS për mbikëqyrjen e aktivitetit të flotës së peshkimit.

.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Për arritjen e objektivave të politikës janë shqyrtuar opsionet e mëposhtme:

Opsioni 1: Mosndërhyrja (status quo): Ky opsion konsiston në ruajtjen e kuadrit ekzistues ligjor dhe institucional pa ndërmarrjen e ndryshimeve në ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar. Avantazhet e këtij opsioni lidhen me mungesën e kostove të menjëhershme ligjore dhe administrative që do të shoqëronin procesin e ndryshimeve ligjore dhe zbatimin e tyre. Megjithatë, ky opsion nuk është konsideruar i përshtatshëm, pasi nuk adreson problematikat e evidentuara gjatë procesit të screening bilateral dhe dialogut teknik me Komisionin Evropian. Ruajtja e status quo-së do të vijonte të linte të paadresuara mospërputhjet ekzistuese me acquis të Bashkimit Evropian, mungesën e bazës ligjore për sistemet moderne të monitorimit elektronik, kufizimet në shkëmbimin e të dhënave dhe dobësitë e mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit. Gjithashtu, ky opsion do të ndikonte negativisht në procesin e mëtejshëm të integrimit evropian dhe në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Kapitulli 13 “Peshkimi”. Për këto arsye, opsioni i mosndërhyrjes nuk është zgjedhur.

Opsioni 2: Ndërhyrja vetëm nëpërmjet akteve nënligjore dhe masave administrative. Ky opsion konsiston në adresimin e problematikave të identifikuara nëpërmjet miratimit ose përditësimit të akteve nënligjore dhe përmirësimeve administrative, pa ndërhyrë në nivel ligji. Avantazhet e këtij opsioni lidhen me fleksibilitetin procedural dhe kohën më të shkurtër të miratimit të akteve nënligjore, si dhe me kostot më të ulëta administrative në afat të shkurtër. Megjithatë, ky opsion nuk është konsideruar i mjaftueshëm, pasi një pjesë e konsiderueshme e problematikave të evidentuara lidhen me mungesën ose papërshtatshmërinë e dispozitave të nivelit ligjor. Çështje të tilla si krijimi dhe funksionimi i Qendrës së Monitorimit të Peshkimit, përdorimi i sistemeve VMS, REM dhe AIS, rregullimi i autorizimeve për peshkim, transmetimi elektronik i të dhënave, si dhe riformulimi i kundërvajtjeve dhe masave administrative kërkojnë

domosdoshmërisht ndërhyrje në nivel ligji. Për më tepër, aktet nënligjore nuk mund të tejkalojnë kufijtë e delegimit ligjor dhe nuk mund të krijojnë kompetenca apo detyrime të reja pa bazë të qartë ligjore. Për këto arsye, ky opsion nuk është zgjedhur.

Opsioni 2: Ndryshimi i kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012 ‘Për peshkimin’, të ndryshuar” (opsioni i preferuar). Ky opsion konsiston në ndërhyrjen në nivel ligji me qëllim përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe krijimin e bazës së nevojshme ligjore për modernizimin e sistemit të kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit.

Avantazhet kryesore të këtij opsioni lidhen me:

- garantimin e përputhshmërisë së plotë të kuadrit ligjor kombëtar me *acquis* të Bashkimit Evropian;
- krijimin e bazës ligjore për funksionimin e Qendrës së Monitorimit të Peshkimit dhe për përdorimin e sistemeve moderne të monitorimit elektronik;
- përmirësimin e gjurmueshmërisë dhe transparencës së sektorit;
- forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe luftës kundër peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP);
- rritjen e sigurisë juridike dhe qartësimin e kompetencave institucionale;
- përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian.

Ky opsion është zgjedhur si opsioni i preferuar, pasi është i vetmi që adreson në mënyrë të plotë problematikat e identifikuar, garanton përputhshmërinë e qëndrueshme me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe krijon bazën juridike të nevojshme për zhvillimin e një sistemi modern, të integruar dhe efektiv të kontrollit dhe monitorimit të sektorit të peshkimit.

Opsioni 3: Ndërhyrja jorregullore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve administrative dhe përmirësimit të praktikave ekzistuese. Ky opsion konsiston në ruajtjen e kuadrit aktual ligjor, duke synuar adresimin e problematikave të identifikuar nëpërmjet forcimit të kapaciteteve administrative dhe institucionale, rritjes së koordinimit ndërinstitutional, përmirësimit të praktikave administrative, trajnimit të stafit, si dhe optimizimit të proceseve ekzistuese të monitorimit dhe kontrollit. Avantazhet kryesore të këtij opsioni lidhen me shmangien e kostove që lidhen me ndryshimet ligjore, fleksibilitetin më të madh administrativ dhe mundësinë e përmirësimit të menjëhershëm të disa proceseve të punës në nivel institucional. Megjithatë, ky opsion nuk është konsideruar i mjaftueshëm, pasi problematikat e evidentuara nuk lidhen vetëm me kapacitetet administrative apo praktikën institucionale, por kryesisht me mungesën ose papërshtatshmërinë e bazës ligjore ekzistuese. Forcimi i administratës dhe përmirësimi i praktikave aktuale nuk mund të sigurojnë përafrimin e nevojshëm me *acquis* të Bashkimit Evropian, nuk mund të krijojnë bazën ligjore për funksionimin e Qendrës së Monitorimit të Peshkimit (QMP), për përdorimin e sistemeve VMS, REM dhe AIS, si dhe për transmetimin elektronik të të dhënave dhe rregullimin e detyrimeve të reja ligjore. Për më tepër, ky opsion nuk garanton adresimin e plotë të rekomandimeve të dala nga procesi i screening bilateral për Kapitullin 13 “Peshkimi” dhe nuk siguron përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit evropian. Për këto arsye, opsioni jorregulator nuk është zgjedhur.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- Identifikoni se kush preket.
- Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.
- Për ndikimet e drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.
 - Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).
 - Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.
- Diskutoni kufizimin e analizës:
 - Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.
 - Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.
 - Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.
- Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:
 - Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.
 - Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.
 - Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).

Identifikimi i grupeve të prekura

Grupet e prekura nga opsioni i preferuar janë:

Qeveria: përfshirë Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, institucionin përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës, Qendrën e Monitorimit të Peshkimit (QMP), strukturat inspektuese dhe institucionet e tjera shtetërore të përfshira në administrimin, monitorimin dhe kontrollin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës.

Biznesi: Ndryshimet prekin subjektet që ushtrojnë aktivitet në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës, duke përfshirë rreth 750 operatorë të anijeve të peshkimit dhe subjekte që ushtrojnë peshkim tregtar artizanal ose profesional, dhe rreth 29 subjekte të akuakulturës, si dhe individët që ushtrojnë aktivitet peshkimi pa mjete lundruese.

Shoqëria civile: përfshirë organizatat mjedisore dhe grupet e interesit që veprojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit detar, biodiversitetit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve biologjike ujore.

Qytetarët: përfshirë konsumatorët e produkteve të peshkimit, komunitetet bregdetare dhe komunitetet e tjera që varen ekonomikisht ose socialisht nga sektori i peshkimit dhe akuakulturës.

Identifikimi i llojeve të ndikimeve për secilin grup të prekur

Për qeverinë, ndikimet e drejtpërdrejta lidhen me riorganizimin institucional, forcimin e kapaciteteve të monitorimit, funksionimin e Qendrës së Monitorimit të Peshkimit, administrimin elektronik të të dhënave dhe miratimin e akteve nënligjore të nevojshme. Ndikimet jo të drejtpërdrejta lidhen me rritjen e efektivitetit të administratës, përmirësimin e koordinimit ndërinstitutional dhe forcimin e pozicionit të Shqipërisë në procesin e integritetit evropian.

Për biznesin, ndikimet e drejtpërdrejta lidhen me detyrimet e reja për monitorim elektronik, raportim elektronik, transmetim të të dhënave, respektim të rregullave për zbarkimin, peshimin, transbordimin dhe gjurmueshmërinë e produkteve të peshkimit. Ndikimet jo të drejtpërdrejta lidhen me përmirësimin e kushteve të konkurrencës, reduktimin e praktikave të paligjshme dhe rritjen e besueshmërisë së produkteve shqiptare në treg.

Për shoqërinë civile, ndikimet e drejtpërdrejta janë të kufizuara, por lidhen me mundësinë për të ndjekur më mirë zhvillimet në sektor dhe për të kontribuar në mbrojtjen e burimeve biologjike ujore. Ndikimet jo të drejtpërdrejta lidhen me përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit detar, ruajtjen e biodiversitetit dhe forcimin e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Për qytetarët, ndikimet e drejtpërdrejta lidhen kryesisht me rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së produkteve të peshkimit, ndërsa ndikimet jo të drejtpërdrejta lidhen me ruajtjen afatgjatë të burimeve peshkore, mbështetjen e komuniteteve që varen nga sektori dhe përmirësimin e furnizimit të qëndrueshëm me produkte peshkimi.

Përshkrimi cilësor i ndikimeve të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura

Për qeverinë, opsioni i preferuar sjell përmirësim të qartë të bazës ligjore dhe institucionale për monitorimin dhe kontrollin e aktivitetit të peshkimit. Krijimi dhe funksionimi i QMP-së, përdorimi i sistemeve VMS, REM dhe AIS, si dhe transmetimi elektronik i të dhënave do të rrisin aftësinë e institucioneve për të monitoruar aktivitetin e flotës së peshkimit në mënyrë më të vazhdueshme dhe efektive.

Për biznesin, ndikimet e drejtpërdrejta konsistojnë në rritjen e detyrimeve për përputhshmëri me rregullat e reja ligjore. Operatorët e sektorit do të duhet të zbatojnë kërkesat për monitorim dhe raportim elektronik, të respektojnë rregullat për autorizimet, zbarkimin, peshimin dhe transbordimin, si dhe të përshtaten me sistemin e ri të kontrollit dhe gjurmueshmërisë.

Për shoqërinë civile, ndikimet e drejtpërdrejta janë kryesisht institucionale dhe informuese, pasi një sistem më i mirë monitorimi dhe raportimi krijon më shumë mundësi për transparencë dhe për ndjekjen e politikave të qëndrueshme në sektorin e peshkimit.

Për qytetarët, ndikimet e drejtpërdrejta lidhen me përfitimin nga një sistem më i besueshëm i gjurmueshmërisë së produkteve të peshkimit dhe nga rritja e kontrollit mbi produktet që hyjnë në zinxhirin e tregtimit.

Analiza sasiore e ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta

Ndikimet sasiore të drejtpërdrejta të projektligjit mund të përcaktohen pjesërisht në këtë fazë. Projektligji krijon bazën ligjore për modernizimin e sistemit të kontrollit dhe monitorimit të peshkimit, ndërsa shtrirja e plotë, kërkesat teknike dhe kostot e disa prej sistemeve do të përcaktohen pas përfundimit të projektit pilot, studimit të fizibilitetit dhe miratimit të akteve nënligjore përkatëse.

Ndikimet për sektorin publik

Qendra e Monitorimit të Peshkimit (QMP) do të funksionojë si strukturë e posaçme pranë institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës. Për funksionimin e saj do të përdoren 5 pozicionet ekzistuese të specialistëve të sistemit VMS dhe do të krijohet 1 pozicion i ri në nivel përgjegjësi sektori. Për rrjedhojë, QMP-ja parashikohet të funksionojë me gjithsej 6 punonjës.

Kostoja vjetore e 5 specialistëve ekzistues përlllogaritet në 8,350,000 lekë. Kjo vlerë është aktualisht e parashikuar në tavanet e miratuara të programit buxhetor 04230 “Mbështetje për Peshkimin” dhe përbën kosto ekzistuese të personelit, e cila do të riorganizohet në funksion të QMP-së. Për rrjedhojë, ajo nuk përbën efekt financiar të ri që lind nga projektligji.

Kostoja vjetore e pozicionit të ri të përgjegjësit të sektorit vlerësohet në rreth 2,000,000 lekë. Kjo kosto përbën ndikim financiar të drejtpërdrejtë të projektligjit, por do të përballohet brenda fondit ekzistues të pagave të Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, pa kërkuar shtesë fondi ose rritje të tavanit buxhetor.

Në total, kostoja vjetore e personelit të QMP-së përlllogaritet në 10,350,000 lekë, nga të cilat 8,350,000 lekë përfaqësojnë koston ekzistuese të 5 specialistëve, ndërsa 2,000,000 lekë përfaqësojnë koston e pozicionit të ri të përgjegjësit të sektorit. E gjithë kjo kosto do të përballohet brenda fondeve të miratuara për DSHPA-në.

Gjithashtu, një kosto tjetër e drejtpërdrejtë dhe e kuantifikueshme për buxhetin e shtetit lidhet me shpërblimin e anëtarëve të dy komisioneve:

Komisioni i Përhershëm i Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit përbëhet nga 5 anëtarë. Për secilin anëtar parashikohen deri në 12 pagesa në vit, me vlerë 10,000 lekë për pagesë, duke krijuar një efekt financiar vjetor prej 600,000 lekësh. Ky komision trajton mesatarisht 100–130 kërkesa në vit;

Komisioni për Shqyrtimin e Ankimimeve përbëhet nga 5 anëtarë. Për secilin anëtar parashikohen deri në 4 pagesa në vit, me vlerë 10,000 lekë për pagesë, duke krijuar një efekt financiar maksimal prej 200,000 lekësh në vit.

Në total, kostoja vjetore e drejtpërdrejtë që lidhet me zbatimin e projektligjit përlllogaritet në 2 800 000 lekë, nga të cilat 2 000 000 lekë për pozicionin e ri të përgjegjësit të QMP-së dhe 800 000 lekë për shpërblimin e anëtarëve të dy komisioneve. Kostoja prej 2 000 000 lekësh do të përballohet brenda fondit ekzistues të pagave të DSHPA-së, pa kërkuar rritje të tavanit buxhetor, ndërsa efekti prej 800 000 lekësh për komisionet përbën nevojë të re financiare, e cila do të planifikohet në PBA-në përkatëse.

Në lidhje me sistemet e monitorimit elektronik, VMS-ja është funksionale që prej vitit 2021 për anijet me gjatësi të përgjithshme të barabartë ose më të madhe se 12 metra. Për anijet me gjatësi nga 9 deri në 11.99 metra parashikohet instalimi dhe integrimi i 35 pajisjeve VMS deri më 31 dhjetor 2027. Kostoja e parashikuar është rreth 40,000 euro dhe do të financohet nga GFCM, pa krijuar efekt financiar për buxhetin e shtetit.

Për sistemin REM do të zbatohet fillimisht një projekt pilot në 1 anije peshkuese. Projekti do të shërbejë për përcaktimin e standardeve teknike, mënyrës së integritimit me sistemet ekzistuese, shtrirjes së zbatimit dhe koston së nevojshme për implementimin e plotë. Për rrjedhojë, numri përfundimtar i pajisjeve REM dhe kostoja e plotë e sistemit nuk mund të

kuantifikohen në këtë fazë. Këto do të përcaktohen pas përfundimit të studimit të fizibilitetit dhe do të parashikohen në PBA-në përkatëse.

Tregues të tjerë sasiorë për sektorin publik do të jenë:

- funksionalizimi i QMP-së me 6 punonjës;
- instalimi dhe integrimi i 35 pajisjeve VMS deri më 31 dhjetor 2027;
- testimi i sistemit REM në 1 anije peshkuese;
- numri vjetor i raportimeve elektronike të administruara nga QMP-ja;
- numri vjetor i kontrolleve të realizuara dhe i shkeljeve të evidentuara nëpërmjet sistemeve elektronike;

.Vlera monetare e ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta

Në përputhje me relacionin shoqërues të projektligjit, kostoja totale vjetore e personelit të Qendrës së Monitorimit të Peshkimit (QMP) përlogaritet në **10,350,000 lekë**, nga të cilat **8 350 000 lekë** për 5 specialistët ekzistues të sistemit VMS dhe rreth **2,000,000 lekë** për pozicionin e ri të përgjegjësit të sektorit. Kostoja e specialistëve është e parashikuar në buxhetin ekzistues, ndërsa kostoja e pozicionit të ri, megjithëse përbën ndikim të drejtpërdrejtë të projektligjit, do të përballohet brenda fondit të miratuar të pagave të DSHPA-së, pa kërkuar rritje të tavanit buxhetor.

Shpërblimi i anëtarëve të dy komisioneve krijon një kosto të re prej **800,000 lekësh në vit**, përkatësisht 600,000 lekë për Komisionin e Përhershëm të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit dhe 200,000 lekë për Komisionin për Shqyrtimin e Ankimimeve. Kjo kosto do të planifikohet në PBA-në përkatëse.

Në total, kostoja vjetore e drejtpërdrejtë që lidhet me projektligjin është **2,800,000 lekë**, nga të cilat 2,000,000 lekë përballohen brenda fondeve ekzistuese dhe 800,000 lekë përbëjnë nevojë të re financiare.

Instalimi i 35 pajisjeve VMS ka një kosto të vlerësuar prej rreth **40,000 euro**, e cila do të financohet nga GFCM dhe nuk krijon efekt financiar për buxhetin e shtetit. Kostoja e zbatimit të plotë të sistemit REM nuk mund të përcaktohet në këtë fazë dhe do të kuantifikohet pas përfundimit të projektit pilot dhe studimit të fizibilitetit, për t'u parashikuar më pas në PBA.

Për bizneset nuk parashikohen kosto monetare për blerjen dhe instalimin e sistemeve VMS dhe REM, pasi ato do të financohen nga qeveria me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë. Mund të lindin vetëm kosto administrative të kufizuara për raportimin dhe përshtatjen me procedurat e reja, të cilat aktualisht nuk mund të kuantifikohen.

Ndikimi mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në sektorin e peshkimit mund të preken nga rritja e detyrimeve administrative dhe teknike, veçanërisht në lidhje me raportimin elektronik, transmetimin e të dhënave dhe respektimin e rregullave të reja për gjurmueshmërinë. Për subjektet më të vogla, këto detyrime mund të kërkojnë kohë përshtatjeje, informim dhe mbështetje administrative nga institucionet përgjegjëse.

Megjithatë, projektligji parashikon zbatim gradual të disa detyrimeve të reja teknike, duke marrë në konsideratë kapacitetet administrative dhe financiare të sektorit. Kjo qasje ndihmon në uljen e barrës së menjëhershme mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe krijon mundësi për përshtatje progresive.

Në afat të mesëm dhe të gjatë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme pritet të përfitojnë nga rritja e formalizimit të sektorit, konkurrenca më e ndershme, reduktimi i praktikave të paligjshme dhe rritja e besueshmërisë së produkteve të peshkimit në treg.

Përshtatja cilësore e ndikimeve jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura

Ndikimet jo të drejtpërdrejta për qeverinë lidhen me rritjen e besueshmërisë institucionale, forcimin e kapaciteteve për përmbushjen e detyrimeve të integritetit evropian dhe përmirësimin e pozitës së Shqipërisë në kuadër të negociatave për Kapitullin 13 “Peshkimi”.

Për biznesin, ndikimet jo të drejtpërdrejta lidhen me krijimin e një tregu më të rregullt dhe më transparent, ku operatorët që respektojnë ligjin nuk dëmtohen nga konkurrenca e pandershme e operatorëve që ushtrojnë aktivitet të paligjshëm ose të paraportuar.

Për shoqërinë civile, ndikimet jo të drejtpërdrejta lidhen me rritjen e mundësive për mbrojtjen e mjedisit detar dhe monitorimin e politikave publike në sektorin e peshkimit.

Për qytetarët, ndikimet jo të drejtpërdrejta lidhen me rritjen e besimit te produktet e peshkimit, mbrojtjen e burimeve natyrore dhe garantimin e furnizimit më të qëndrueshëm me produkte peshkimi në afat të gjatë.

Ndikimi mbi konkurrencën

Opsioni i preferuar pritet të ketë ndikim pozitiv mbi konkurrencën në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës. Forcimi i kontrollit, gjurmueshmërisë dhe monitorimit elektronik ul hapësirat për operatorët që veprojnë në mënyrë të paligjshme ose që nuk raportojnë aktivitetin e tyre. Kjo krijon kushte më të barabarta për operatorët që zbatojnë ligjin dhe përmirëson funksionimin e tregut.

Në të njëjtën kohë, zbatimi i detyrimeve të reja duhet të bëhet në mënyrë proporcionale dhe graduale, në mënyrë që të mos krijojë barrë të tepruar për operatorët më të vegjël ose për subjektet që kanë kapacitete më të kufizuara administrative dhe financiare.

Kufizimet e analizës

Analiza mbështetet në supozimin se dispozitat e projektligjit do të zbatohen në mënyrë graduale dhe se aktet nënligjore të nevojshme do të miratohen brenda afateve të parashikuara. Gjithashtu, analiza mbështetet në supozimin se funksionet e QMP-së do të realizohen përmes riorganizimit të strukturave ekzistuese dhe pa krijuar efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

Provat që mbështesin këto supozime janë të rëndësishme, nga procesi i screening bilateral për Kapitullin 13 “Peshkimi”. Megjithatë, projektligji vendos disa detyrime të reja për operatorët privatë lidhur me përdorimin e sistemeve elektronike të monitorimit. Këto përfshijnë Sistemin e Monitorimit të Anijeve (VMS), i cili transmeton të dhënat për pozicionin dhe lëvizjen e anijes; Sistemin e Monitorimit Elektronik në Distançë (REM), i cili përdor kamera dhe pajisje të tjera elektronike në bord për kontrollin e aktivitetit të peshkimit; si dhe Sistemin Automatik të Identifikimit (AIS), i cili mundëson identifikimin dhe gjurmimin e anijes.

Operatorët do të kenë detyrimin të lejojnë instalimin, të mbajnë pajisjet funksionale, të mos i manipulojnë dhe të transmetojnë informacionin e kërkuar. Megjithatë, kostot për blerjen, instalimin dhe integrimin e sistemeve nuk do të përballohen nga bizneset. Për 35 anijet me gjatësi nga 9 deri në 11,99 metra, pajisjet VMS do të financohen nga GFCM, ndërsa sistemi REM do të testohet fillimisht nëpërmjet një projekti pilot. Pas studimit të fizibilitetit, kostoja e zbatimit të plotë të REM-së do të përcaktohet dhe do të planifikohet nga qeveria në PBA-në përkatëse. Për bizneset mund të lindin vetëm kosto administrative të kufizuara për raportimin periodik dhe përshtatjen me procedurat e reja.

Realizimi i përfitimeve mund të pengohet nga vonesa në miratimin e akteve nënligjore, kapacitete të kufizuara administrative ose teknike, mungesë e ndërgjegjësimit të operatorëve, kosto më të larta se sa parashikohet për përshtatjen teknike të subjekteve private, si dhe vështirësi në integrimin e plotë të sistemeve elektronike të monitorimit dhe raportimit.

Përmbledhje e vlerësimit të opsioneve

Opsioni i mosndërrhyrjes nuk krijon kosto të menjëhershme për buxhetin ose bizneset, por nuk adreson mospërputhjet me acquis të Bashkimit Evropian, nuk forcon sistemin e kontrollit dhe monitorimit dhe nuk krijon bazën ligjore për përdorimin e sistemeve moderne elektronike. Për këtë arsye, ndikimi neto i këtij opsioni vlerësohet negativ në aspektin institucional, mjedisor dhe të integritetit evropian.

Opsioni jorregullator, përmes forcimit të administratës dhe praktikave ekzistuese, mund të sjellë përmirësime të kufizuara në afat të shkurtër, por nuk krijon bazën ligjore të nevojshme për QMP-në, VMS, REM, AIS, transmetimin elektronik të të dhënave dhe detyrimet e reja për subjektet. Për këtë arsye, ndikimi i tij neto është i kufizuar dhe i pamjaftueshëm për arritjen e objektivave të politikës.

Opsioni i ndërhyrjes vetëm përmes akteve nënligjore dhe masave administrative ka avantazh në fleksibilitet dhe kohë më të shkurtër procedurale, por nuk mund të krijojë kompetenca, detyrime ose sanksione të reja pa bazë në ligj. Për këtë arsye, ky opsion nuk është i mjaftueshëm për të adresuar problemin në mënyrë të plotë.

Opsioni i ndryshimit ligjor, si opsioni i preferuar, krijon bazën juridike të nevojshme për modernizimin e sistemit të kontrollit dhe monitorimit të peshkimit, përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian, forcimin e gjurmueshmërisë së produkteve dhe luftën kundër peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar.

Ky opsion shoqërohet me kosto financiare për zbatimin e tij. Kostoja e drejtpërdrejtë dhe e kuantifikueshme për llogaritjet në 2,8 milionë lekë në vit, nga të cilat 2 milionë lekë lidhen me pozicionin e ri të përgjegjësimit të Qendrës së Monitorimit të Peshkimit dhe 0,8 milionë lekë me shpërblimin e anëtarëve të dy komisioneve. Kostoja e pozicionit të ri do të përballohet brenda fondit ekzistues të pagave të DSHPA-së, ndërsa kostoja për komisionet do të planifikohet në PBA-në përkatëse.

Projektligji shoqërohet gjithashtu me një kosto të njëhershme prej 3,848 milionë lekësh për blerjen, instalimin dhe integrimin e 35 pajisjeve VMS për anijet me gjatësi nga 9 deri në 11,99 metra, e cila do të realizohet me mbështetjen e projektit përkatës brenda vitit 2027. Për sistemin AIS nuk parashikohen kosto financiare shtesë, pasi sistemi është ekzistues dhe funksional, ndërsa projektligji rregullon detyrat dhe procedurat për përdorimin e tij në monitorimin e anijeve peshkuese.

Kostot për shtrirjen e sistemit VMS tek anijet me gjatësi më të vogël se 9 metra dhe për zbatimin e plotë të sistemit REM nuk mund të përcaktohen në mënyrë të besueshme në këtë fazë. Për sistemin VMS, vlera do të detajohet pas përfundimit të anketimit të flotës dhe studimit të tregut, ndërsa për REM-in pas përfundimit të projektit pilot dhe studimit të fizibilitetit. Fondet përkatëse do të përballohen brenda tavaneve të miratuara të programit buxhetor 04230 “Mbështetje për Peshkimin”.

Në krahasim me alternativat e tjera, opsioni i ndryshimit ligjor është i vetmi që mundëson krijimin e detyrimeve, kompetencave, procedurave dhe masave administrative të zbatueshme për institucionet dhe operatorët. Përfitimet e tij janë jomonetare dhe lidhen me rritjen e rregullshmërisë, standardizimin e procedurave, forcimin e kontrollit, përmirësimin e gjurmueshmërisë dhe të kushteve të tregtimit, garantimin e konkurrencës së ndershme dhe përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian.

Përlllogaritja më e mirë e përgjithshme neto e ndikimit monetar

Për opsionin e mosndërhyrjes, kostot dhe përfitimet shtesë monetare paraqiten me vlerën zero, pasi ky opsion ruan situatën aktuale. Megjithatë, mosndërhyrja nuk adreson mangësitë e sistemit të monitorimit dhe kontrollit, nuk përmirëson gjurmueshmërinë dhe standardet e tregtimit dhe nuk siguron përafrimin me kërkesat e reja të acquis të Bashkimit Evropian.

Opsioni jorregullator mund të përmirësojë pjesërisht praktikat administrative brenda kapaciteteve ekzistuese, por nuk mund të krijojë detyrime ligjore të detyrueshme për operatorët, të përcaktojë kompetenca të reja për institucionet ose të vendosë masa administrative në rast shkeljeje. Për rrjedhojë, ndikimi dhe përfitimet e këtij opsioni do të ishin të kufizuara.

Edhe ndërhyrja vetëm përmes akteve nënligjore nuk mund të realizojë objektivat e politikës, pasi detyrimet për instalimin dhe përdorimin e sistemeve elektronike, transmetimin e të dhënave, funksionimin e QMP-së dhe zbatimin e masave administrative kërkojnë bazë ligjore të shprehur. Në mungesë të kësaj baze, aktet nënligjore do të paraqisnin risk të lartë ligjor dhe zbatueshmërie.

Për opsionin e ndryshimit ligjor, vlera aktuale e kostove të kuantifikuara për periudhën 10-vjeçare përlllogaritet në **26,41 milionë lekë**. Duke qenë se përfitimet e pritshme nuk gjenerojnë të ardhura monetare të drejtpërdrejta, vlera aktuale neto monetare rezulton **–26,41 milionë lekë**. Megjithëse kjo vlerë është negative dhe pasqyron kostot financiare të zbatimit të projektligjit, opsioni krijon përfitime të rëndësishme jomonetare, të cilat lidhen me rritjen e rregullshmërisë dhe transparencës, standardizimin e procedurave, forcimin e monitorimit dhe kontrollit, përmirësimin e gjurmueshmërisë dhe të kushteve të tregtimit, si dhe përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian. Për rrjedhojë, vlera negative monetare nuk e bën këtë opsion të pafavorshëm, pasi përfitimet rregullatore, institucionale, ekonomike dhe mjedisore të pritshme vlerësohen thelbësore për arritjen e objektivave të politikës.

Për bizneset nuk parashikohen kosto për blerjen dhe instalimin e sistemeve VMS dhe REM. Operatorët do të kenë detyrime për përdorimin korrekt të pajisjeve dhe transmetimin e

informacionit, të cilat mund të shoqërohen me kosto administrative të kufizuara, por aktualisht të pakuantifikueshme.

Megjithëse status quo-ja nuk krijon kosto financiare shtesë, ruajtja e saj do të linte të patrajuara problematikat ekzistuese. Opsioni i ndryshimit ligjor, pavarësisht kostos së identifikuar, sjell përfitime të rëndësishme në rregullsi, standardizim, transparencë, gjurmueshmëri, kontroll dhe tregtim. Për këtë arsye, ai vlerësohet si alternativa më efektive dhe e përshtatshme për arritjen e objektivave të politikës.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar është ndërhyrja rregullatore nëpërmjet miratimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012 ‘Për peshkimin’, të ndryshuar”. Ky opsion është zgjedhur pasi përbën mënyrën më të përshtatshme dhe më efektive për adresimin e problematikave të identikuara në sektorin e peshkimit, të cilat nuk mund të zgjidhen në mënyrë të plotë as përmes ruajtjes së gjendjes aktuale, as përmes masave jorregullatore dhe as vetëm përmes akteve nënligjore.

Së pari, zgjedhja e këtij opsioni lidhet me nevojën për përditësimin e kuadrit ligjor kombëtar në përputhje me zhvillimet më të fundit të *acquis* të Bashkimit Evropian. Ligji nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar, megjithëse ka shërbyer si baza kryesore rregullatore e sektorit, nuk reflekton plotësisht kërkesat e reja të sistemit evropian të kontrollit të peshkimit, veçanërisht ato që lidhen me monitorimin elektronik të flotës, transmetimin elektronik të të dhënave, përdorimin e sistemeve moderne të kontrollit dhe rritjen e gjurmueshmërisë së produkteve të peshkimit. Për këtë arsye, ndërhyrja në nivel ligji është e domosdoshme për të siguruar një përafrim të qëndrueshëm dhe të plotë me *acquis* të Bashkimit Evropian.

Së dyti, problematikat e evidentuara kanë natyrë normativo-institucionale dhe kërkojnë krijimin e një baze të qartë juridike. Projektligji rregullon funksionimin e Qendrës së Monitorimit të Peshkimit (QMP), si struktura përgjegjëse për marrjen, përpunimin dhe kontrollin e të dhënave; përdorimin e Sistemit të Monitorimit të Anijeve (VMS), i cili transmeton pozicionin dhe lëvizjen e anijes; Sistemit të Monitorimit Elektronik në Distançë (REM), i cili përdor kamera dhe pajisje të tjera elektronike në bord; si dhe Sistemit Automatik të Identifikimit (AIS), që mundëson identifikimin dhe gjurmimin e anijeve.

Për operatorët dhe kapitenët e anijeve krijohen detyrime për lejin e instalimit dhe mbajtjen funksionale të pajisjeve, mosmanipulimin e tyre, transmetimin elektronik të të dhënave, plotësimin e librit elektronik të peshkimit dhe dërgimin e deklaratave të zbarkimit dhe transbordimit. Operatorët që kryejnë peshimin e produkteve të peshkimit duhet të sigurojnë saktësinë e të dhënave dhe të ruajnë regjistrat për një periudhë trevjeçare. Kostot e blerjes, instalimit dhe integritetit të sistemeve VMS dhe REM nuk do të përballohen nga operatorët privatë, por nga qeveria, me mbështetjen e projekteve dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Për institucionet publike krijohen përgjegjësi për funksionimin e QMP-së, administrimin dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave, monitorimin e aktivitetit të flotës, kontrollin e respektimit të detyrimeve dhe marrjen e masave administrative në rast shkeljeje. Projektligji riformulon gjithashtu shkeljet e rënda dhe sanksionet për mosinstalimin, dëmtimin,

manipulimin ose nxjerrjen jashtë funksionit të sistemeve elektronike, si dhe për mosrespektimin e detyrimeve të raportimit.

Këto rregulla, përgjegjësi institucionale, kompetenca administrative dhe pasoja juridike nuk mund të përcaktohen plotësisht vetëm nëpërmjet udhëzimeve administrative ose përmirësimit të praktikave ekzistuese, por kërkojnë një bazë të qartë ligjore. Zbatimi i tyre shoqërohet me një kosto të drejtpërdrejtë prej 2,8 milionë lekësh në vit, nga të cilat 2 milionë lekë për pozicionin e ri të përgjegjësit të QMP-së dhe 0,8 milionë lekë për shpërblimin e anëtarëve të dy komisioneve. Gjithashtu, instalimi dhe integrimi i 35 pajisjeve VMS për anijet me gjatësi nga 9 deri në 11,99 metra ka një kosto të njehershme prej 3,848 milionë lekësh. Në total, vlera aktuale e kostove për periudhën 10-vjeçare përlogaritet në 26,41 milionë lekë.

Kostot për shtrirjen e sistemit VMS tek anijet me gjatësi më të vogël se 9 metra dhe për zbatimin e plotë të sistemit REM do të përcaktohen pas përfundimit të anketimit të flotës, studimit të tregut dhe studimit të fizibilitetit dhe do të përballohen brenda tavaneve të programit buxhetor 04230 “Mbështetje për Peshkimin”. Për rrjedhojë, ndërhyrja në nivel ligji është e nevojshme për të garantuar zbatim të njëtrajtshëm, ndarje të qartë të përgjegjësiave dhe funksionim efektiv të sistemit të monitorimit, kontrollit dhe raportimit në sektorin e peshkimit. *Së treti*, ky opsion krijon bazën e nevojshme për modernizimin real të sistemit të kontrollit dhe monitorimit të peshkimit. Pa ndryshime ligjore, administrata mund të përmirësojë vetëm pjesërisht mënyrën e punës, por nuk mund të vendosë një sistem të integruar dhe të detyrueshëm të monitorimit elektronik, nuk mund të garantojë transmetim të standardizuar të të dhënave dhe nuk mund të sigurojë zbatimin uniform të detyrimeve nga të gjithë operatorët e sektorit. Përmes ndryshimit të ligjit krijohen kushtet për një sistem më të organizuar, më transparent dhe më të kontrollueshëm, ku të dhënat mbi aktivitetin e peshkimit mbledhen, transmetohen dhe administrohen në mënyrë elektronike.

Së katërti, opsioni i preferuar forcon mekanizmat për parandalimin dhe luftën kundër peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP). Përmirësimi i sistemit të monitorimit, gjurmueshmërisë dhe kontrollit është thelbësor për të reduktuar hapësirat për veprimtari të paligjshme, për të rritur efektivitetin e inspektimit dhe për të garantuar menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve biologjike detare. Në këtë drejtim, ndryshimet ligjore nuk kanë vetëm karakter teknik, por ndikojnë drejtpërdrejt në mbrojtjen e mjedisit detar, në ruajtjen e rezervave peshkore dhe në funksionimin e drejtë të tregut.

Së pesti, ky opsion garanton qartësi më të madhe juridike për subjektet që ushtrojnë aktivitet në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës. Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara qartësohen përkufizimet, procedurat, detyrimet për raportim, autorizimet, kompetencat institucionale, si dhe pasojat në rast të shkeljes së ligjit. Kjo krijon më shumë siguri juridike për operatorët ekonomikë, redukton interpretimet e ndryshme në praktikë dhe ndihmon në zbatimin më të njëtrajtshëm të ligjit.

Së gjashti, opsioni i ndryshimit ligjor është proporcional me natyrën dhe shtrirjen e problemit. Problemi nuk është i kufizuar vetëm në një procedurë administrative ose në një hallkë të veçantë të sektorit, por prek të gjithë sistemin e kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit, nga autorizimi dhe ushtrimi i aktivitetit, te monitorimi i flotës, raportimi elektronik, zbarkimi, peshimi, transbordimi, tregtimi fillestar dhe trajtimi i shkeljeve. Për këtë arsye, ndërhyrja e pjesshme ose vetëm administrative nuk do të ishte e mjaftueshme. Ndërhyrja në nivel ligji është e nevojshme për të krijuar një kuadër të plotë, koherent dhe të zbatueshëm.

Së shtati, opsioni i preferuar mbështet drejtpërdrejt objektivat strategjikë të qeverisë për integrimin evropian dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të peshkimit. Ai është në përputhje me Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027, me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030, si dhe me angazhimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të Kapitullit 13 “Peshkimi”. Përmes këtij opsioni, Shqipëria avancohet në përafrimin e legjislacionit me standardet e Bashkimit Evropian dhe forcon kapacitetin institucional për zbatimin e këtyre standardeve.

Sa i përket kostove, vlerësimi është mbështetur në efektet financiare të identifikuara në këtë fazë. Kostoja totale vjetore e personelit të Qendrës së Monitorimit të Peshkimit (QMP) përlllogarit në **10,350,000 lekë**, nga të cilat **8,350,000 lekë** për 5 specialistët ekzistues dhe **2,000,000 lekë** për pozicionin e ri të përgjegjës të sektorit. Kostoja ekzistuese dhe ajo e pozicionit të ri do të përballohen brenda fondit të miratuar të pagave të DSHPA-së, pa kërkuar rritje të tavanit buxhetor.

Projektligji krijon gjithashtu një efekt financiar shtesë prej **800,000 lekësh në vit** për shpërblimin e anëtarëve të dy komisioneve, përkatësisht 600,000 lekë për Komisionin e Përhershëm të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit dhe 200,000 lekë për Komisionin për Shqyrtimin e Ankimeve. Kjo kosto do të planifikohet në PBA-në përkatëse. Në total, kostoja vjetore e drejtpërdrejtë që lidhet me masat e reja të projektligjit është **2,800,000 lekë**, nga të cilat 2,000,000 lekë përballohen brenda fondeve ekzistuese dhe 800,000 lekë përbëjnë nevojë të re financiare.

Instalimi i 35 pajisjeve VMS ka një kosto të vlerësuar prej rreth **40,000 eurosh**, e cila do të financohet nga GFCM dhe nuk krijon efekt financiar për buxhetin e shtetit. Kostoja e zbatimit të plotë të sistemit REM do të përcaktohet pas përfundimit të projektit pilot dhe studimit të fizibilitetit dhe do të parashikohet në PBA-në përkatëse.

Për subjektet private nuk parashikohen kosto për blerjen dhe instalimin e sistemeve VMS dhe REM, pasi ato do të financohen nga qeveria me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë. Mund të lindin vetëm kosto administrative të kufizuara për raportimin periodik dhe përshtatjen e procedurave të brendshme. Këto nuk mund të kuantifikohen aktualisht për shkak të mungesës së të dhënave në terren dhe të specifikimeve përfundimtare teknike.

Bazuar në kostot e identifikuara dhe në mënyrën e parashikuar të financimit të tyre, opsioni i preferuar vlerësohet financiarisht i përballueshëm. Përfitimet e pritshme lidhen me rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë, forcimin e konkurrencës së ndershme, luftën kundër peshkimit të paligjshëm dhe menaxhimin më të qëndrueshëm të burimeve peshkore.

Në përfundim, opsioni i ndryshimit ligjor është zgjedhur pasi është opsioni më gjithëpërfshirës, më efektiv dhe më i qëndrueshëm për trajtimin e problemit. Ai krijon bazën ligjore të nevojshme për modernizimin e sektorit, garanton përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian, forcon kontrollin dhe monitorimin e aktivitetit të peshkimit, rrit sigurinë juridike për subjektet dhe institucionet, si dhe mbështet objektivat strategjikë të vendit për integrim evropian dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Përcaktimi i kriterëve që tregojnë arritjen e objektivave

1. Krijimi dhe funksionalizimi i Qendrës së Monitorimit të Peshkimit (QMP);
2. Rritja e numrit të anijeve të monitoruara përmes sistemeve elektronike (VMS, REM, AIS);
3. Rritja e nivelit të raportimit elektronik të të dhënave të peshkimit;

4. Rritja e numrit të kontrolleve dhe përmirësimi i zbatimit të legjislacionit në këtë fushë;
5. Reduktimi i rasteve të peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP);

Vendosja e peshës së kriterëve sipas rëndësisë relative

1. Efektiviteti në krijimi dhe funksionalizimi i Qendrës së Monitorimit të Peshkimit (QMP)-5
2. Efektiviteti në rritjen e numrit të anijeve të monitoruara përmes sistemeve elektronike (VMS, REM, AIS)-5
3. Efektiviteti në rritjen e nivelit të raportimit elektronik të të dhënave të peshkimit-4
4. Efektiviteti në rritjen e numrit të kontrolleve dhe përmirësimin e zbatimit të legjislacionit në këtë fushë-2
5. Efektiviteti në reduktimi i rasteve të peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP);-3
6. Kostot efektiviteti-5.

Përcaktimi i **shkallës së performancës** nëpërmjet intervalit të pikëve nga 0 – 6. **Vendosja e pikëve të opsioneve** përkundrejt secilit kriter sipas matricës së mëposhtme.

Matrica e performancës:

Kriteret	Pesha (Rëndësia relative)	Opsioni 0		Opsioni 1		Opsioni 2		Opsioni 3	
		Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)
Efektiviteti në krijimi dhe funksionalizimi i Qendrës së Monitorimit të Peshkimit (QMP);	5	1	5	2	10	4	20	2	10
Efektiviteti në rritjen e numrit të anijeve të monitoruara përmes sistemeve elektronike (VMS, REM, AIS);	5	0	0	0	0	5	25	0	0
Efektiviteti në rritjen e nivelit të raportimit elektronik të të	4	1	4	1	4	4	16	1	4

dhënave të peshkimit									
Efektiviteti në rritjen e numrit të kontrolleve dhe përmirësimin e zbatimit të legjislacionit në këtë fushë-4	2	1	2	2	4	2	4	2	4
Efektiviteti në reduktimi i rasteve të peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP);	3	1	3	1	3	3	9	1	3
Kostot	5	1	5	2	10	5	25	2	10
Pikët totale për secilin opsion			19		31		99		31

Analiza me shumë kritere tregon se ndryshimi i kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012 ‘Për peshkimin’, të ndryshuar” (opsioni i preferuar).

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përkrahuesit masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

Njësitë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur

Përgjegjësia kryesore për zbatimin e opsionit të zgjedhur i takon Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), e cila do të koordinojë procesin e zbatimit të projektligjit, do të monitorojë progresin e tij dhe do të sigurojë përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian.

Drejtorisë së Përgjithshme të Peshkimit dhe Akuakulturës do të jetë përgjegjës për zbatimin operacional të dispozitave të ligjit, administrimin e procedurave të autorizimit, administrimin e të dhënave, monitorimin e aktivitetit të peshkimit dhe koordinimin me institucionet e tjera përgjegjëse.

Qendra e Monitorimit të Peshkimit (QMP) do të jetë struktura përgjegjëse për monitorimin në kohë reale të aktivitetit të flotës së peshkimit, administrimin e sistemeve elektronike të monitorimit dhe analizimin e të dhënave të transmetuara nga subjektet e sektorit.

Inspektoriati i Peshkimit është institucioni përgjegjës për verifikimin e zbatimit të dispozitave ligjore, kryerjen e kontrolleve administrative dhe teknike, si dhe marrjen e masave administrative në rast të konstatimit të shkeljeve.

Pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur

Një ndër pengesat kryesore të mundshme lidhet me nevojën për përshtatjen graduale të administratës dhe operatorëve ekonomikë me kërkesat e reja ligjore, veçanërisht në lidhje me përdorimin e sistemeve elektronike të monitorimit dhe raportimit.

Vonesa në miratimin e akteve nënligjore të nevojshme mund të ndikojë negativisht në zbatimin në kohë dhe në mënyrë efektive të dispozitave të reja ligjore. Gjithashtu, kapacitetet administrative dhe teknike të institucioneve përgjegjëse, si dhe niveli i njohurive teknike të operatorëve të sektorit, mund të ndikojnë në ritmin e zbatimit të reformës.

Një pengesë tjetër e mundshme lidhet me nevojën për integrimin dhe funksionimin e sistemeve elektronike të monitorimit dhe shkëmbimit të të dhënave ndërmjet institucioneve përgjegjëse, proces i cili mund të kërkojë kohë dhe koordinim të vazhdueshëm ndër-institucional.

Masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës

Për të siguruar zbatimin efektiv të projektligjit, aktet nënligjore të nevojshme do të miratohen brenda afateve të përcaktuara në ligj. Këto akte do të përcaktojnë procedurat e monitorimit dhe raportimit elektronik, standardet teknike të sistemeve dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe operatorëve.

Qendra e Monitorimit të Peshkimit do të funksionojë me 6 punonjës, përkatësisht 5 specialistë ekzistues të sistemit VMS dhe 1 përgjegjës sektori. Për sistemin VMS nuk parashikohen trajnime shtesë, pasi specialistët aktualë janë të angazhuar në administrimin e këtij sistemi dhe disponojnë kapacitetet profesionale përkatëse.

Nevoja për trajnim do të vlerësohet në kuadër të zbatimit të Sistemit të Monitorimit Elektronik në Distançë (REM). Numri i punonjësve që do të trajnohen, përmbajtja e trajnimit dhe kostoja përkatëse do të përcaktohen pas përfundimit të projektit pilot dhe studimit të fizibilitetit. Çdo efekt financiar që do të rezultojë do të planifikohet në PBA-në e programit 04230 “Mbështetje për Peshkimin”, përpara zbatimit të plotë të sistemit.

Gjithashtu, do të ndërmerren masa për funksionalizimin e Qendrës së Monitorimit të Peshkimit, zhvillimin dhe integrimin e sistemeve elektronike të monitorimit dhe raportimit, si dhe për garantimin e shkëmbimit të sigurt dhe të vazhdueshëm të të dhënave ndërmjet institucioneve përgjegjëse.

Për të lehtësuar përshtatjen e subjekteve të sektorit me kërkesat e reja ligjore, do të zhvillohen aktivitete informuese dhe udhëzuese për operatorët ekonomikë lidhur me detyrimet e reja për monitorimin, raportimin dhe transmetimin elektronik të të dhënave.

Kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës do të jenë të detyruara të respektojnë kërkesat ligjore dhe nënligjore që lidhen me autorizimet për peshkim, monitorimin elektronik të aktivitetit të peshkimit, raportimin dhe transmetimin elektronik të të dhënave, procedurat e zbarkimit dhe transbordimit, peshimin dhe gjurmueshmërinë e produkteve të peshkimit.

Institucionet përgjegjëse do të monitorojnë përputhshmërinë me kërkesat ligjore nëpërmjet kontrolleve administrative dhe inspektimeve në terren, monitorimit elektronik të aktivitetit të peshkimit, analizës së të dhënave të transmetuara dhe zbatimit të masave administrative të parashikuara nga legjislacioni në fuqi në rast të konstatimit të shkeljeve.

Respektimi i kërkesave të reja ligjore do të mbështetet gjithashtu nëpërmjet shkëmbimit elektronik të informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe përdorimit të sistemeve moderne të kontrollit dhe monitorimit, me qëllim garantimin e një zbatimi të njëtrajtshëm dhe efektiv të legjislacionit në sektorin e peshkimit.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre*

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR): Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural do të ushtrojë funksionin e monitorimit strategjik dhe mbikëqyrjes së përgjithshme të zbatimit të projektligjit. Në këtë kuadër, MBZHR do të monitorojë realizimin e objektivave të politikës në sektorin e peshkimit, nivelin e zbatimit të dispozitave ligjore dhe nënligjore, si dhe progresin e arritur në drejtim të përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, ministria do të analizojë periodikisht raportet e institucioneve të varësisë dhe do të ndërmarrë masat e nevojshme për përmirësimin e efektivitetit të zbatimit të legjislacionit.

Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës (DSHPA): Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës do të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme respektimin e detyrimeve ligjore nga subjektet e sektorit të peshkimit dhe akuakulturës. Në kuadër të kompetencave të tij, ky institucion do të mbledhë, administrojë dhe analizojë të dhënat mbi aktivitetin e peshkimit dhe akuakulturës, do të monitorojë zbatimin e procedurave që lidhen me lejet dhe autorizimet e peshkimit, si dhe do të raportojë periodikisht pranë MBZHR mbi ecurinë e zbatimit të projektligjit dhe problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të tij.

Qendra e Monitorimit të Peshkimit (QMP): Qendra e Monitorimit të Peshkimit do të jetë struktura qendrore përgjegjëse për monitorimin operacional në kohë reale të aktivitetit të flotës së peshkimit. Nëpërmjet sistemeve elektronike të monitorimit, përfshirë VMS, AIS dhe REM, QMP do të monitorojë lëvizjet dhe aktivitetin e anijeve peshkuese, do të administrojë dhe analizojë të dhënat elektronike të transmetuara nga subjektet e sektorit dhe do të identifikojë rastet e mundshme të mosrespektimit të legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, QMP do të sigurojë shkëmbimin e informacionit me autoritetet kompetente kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të forcimit të kontrollit dhe luftës kundër peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP).

Strukturat inspektuese përgjegjëse për kontrollin e aktivitetit të peshkimit: Strukturat inspektuese do të monitorojnë dhe verifikojnë në terren respektimin e dispozitave të

projektligjit nga subjektet e sektorit. Në ushtrim të funksioneve të tyre, këto struktura do të kryejnë inspektime administrative dhe teknike, do të konstatojnë shkeljet e legjislativës, do të marrin masat administrative përkatëse dhe do të raportojnë periodikisht mbi rezultatet e kontrolleve të kryera. Gjetjet dhe të dhënat e siguruar gjatë veprimtarisë inspektuese do të shërbejnë si bazë për vlerësimin e efektivitetit të zbatimit të projektligjit dhe për identifikimin e nevojave për ndërhyrje të mëtejshme rregullatore.

Këta indikatorë lidhen drejtpërdrejt me objektivat kryesore të projektligjit: forcimin e monitorimit dhe kontrollit, digjitalizimin e proceseve, luftën kundër peshkimit të paligjshëm dhe zbatimin efektiv të kuadrit të ri ligjor.

1. **Përqindja e anijeve peshkuese të pajisura me Sistemin e Monitorimit të Anijeve (VMS) dhe/ose REM**, në raport me numrin total të anijeve të detyruara për instalimin e tyre.
2. **Numri i deklaratave elektronike të transmetuara** (libri elektronik i peshkimit, deklaratat e zbarkimit dhe transbordimit) në raport me numrin total të operacioneve të peshkimit.
3. **Numri i rasteve të identifikuar të peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP)** dhe tendenca e tyre në kohë.
4. **Shkalla e funksionalitetit të Qendrës së Monitorimit të Peshkimit (QMP)**, e matur nëpërmjet operimit të saj dhe përpunimit elektronik të të dhënave.
5. **Përqindja e akteve nënligjore të miratuara** për zbatimin e ligjit brenda afateve të përcaktuara.

Për problematikat e evidentuara, mund të parashikohen këto masa:

- **Forcimi i kapaciteteve teknike dhe administrative**, nëpërmjet pajisjes së institucioneve me infrastrukturën e nevojshme dhe rritjes së burimeve njerëzore.
- **Miratimi në kohë i akteve nënligjore**, për të garantuar zbatimin e plotë dhe efektiv të dispozitave të ligjit.
- **Zbatimi gradual i detyrimeve të reja teknike**, duke parashikuar periudha tranzitore për subjektet e sektorit.
- **Organizimi i programeve të trajnimit dhe ndërgjegjësimi**, për stafin institucional dhe operatorët e sektorit të peshkimit.
- **Përmirësimi i sistemeve të shkëmbimit dhe administrimit të të dhënave**, për të siguruar ndërveprueshmërinë ndërmjet institucioneve përgjegjëse.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	<u>1</u>	<u>0.952</u> <u>835</u>	<u>0.907</u> <u>894</u>	<u>0.865</u> <u>073</u>	<u>0.824</u> <u>271</u>	<u>0.785</u> <u>394</u>	<u>0.748</u> <u>351</u>	<u>0.713</u> <u>055</u>	<u>0.679</u> <u>423</u>	<u>0.647378</u>
Kosto për buxhetin – një herë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kosto për buxhetin – në vazhdim	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8
Kosto për biznesin – një herë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kosto për biznesin – në vazhdim	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0

Kosto për grupet e tjera – një herë	0.0	3.848	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kosto në total	0.0000	6.6480	2.8000	2.8000	2.8000	2.8000	2.8000	2.8000	2.8000	2.8000
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	0.0000	6.3344	2.5421	2.4222	2.3080	2.1991	2.0954	1.9966	1.9024	1.8127
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Përfitimi për biznesin – një herë	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Përfitimi për biznesin – në vazhdim	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Kosto për buxhetin – në vazhdim	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Përfitimi në total	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Vlera aktuale e koston në total	23.61 lekë									
Vlera aktuale e përfitimit në total	0 lekë									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e koston në total	-23.61 lekë									

Kostoja e drejtpërdrejtë vjetore e këtij projektligji për buxhetin e shtetit përlllogaritet në 2,8 milionë lekë. Kjo kosto përbëhet nga efekti financiar i pozicionit të ri të përgjegjësit të Qendrës së Monitorimit të Peshkimit (QMP), si dhe nga shpërblymimi i anëtarëve të dy komisioneve të parashikuara në projektligj.

1. Kostoja e Qendrës së Monitorimit të Peshkimit

Qendra e Monitorimit të Peshkimit do të funksionojë me 6 punonjës, përkatësisht 5 specialistë ekzistues të Sistemit të Monitorimit të Anijeve (VMS) dhe 1 përgjegjës sektori.

Kostoja vjetore e 5 specialistëve ekzistues përlllogaritet në 8,35 milionë lekë. Kjo vlerë është e parashikuar në buxhetin aktual të Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe do të vazhdonte të përballohej edhe në kushtet e status quo-së. Përfshirja e këtyre pozicioneve në strukturën e QMP-së përfaqëson riorganizim funksional dhe, për rrjedhojë, nuk përbën kosto të re që lind nga projektligji.

Kostoja vjetore e pozicionit të ri të përgjegjësit të QMP-së përlllogaritet në 2 milionë lekë, e cila parashikohet të fillojë pas vitit 2026 (deri në miratimin e ligjit dhe miratimit të strukturës). Kjo kosto do të përballohet brenda fondit ekzistues të pagave të DSHPA-së, pa kërkuar rritje të tavanit buxhetor. Megjithatë, ajo përfshihet në vlerësimin e ndikimit si kosto e drejtpërdrejtë e projektligjit, pasi përballimi i saj brenda fondeve të miratuara nuk e përjashton nga kategorizimi si kosto.

Në total, kostoja vjetore e personelit të QMP-së përlllogaritet në 10,35 milionë lekë, nga të cilat 8,35 milionë lekë përbëjnë kosto ekzistuese, ndërsa 2 milionë lekë lidhen me pozicionin e ri.

Për sistemin VMS nuk parashikohen kosto shtesë për trajnimin e 5 specialistëve, pasi ata janë aktualisht të angazhuar në administrimin e këtij sistemi dhe disponojnë kapacitetet profesionale përkatëse.

2. Kostoja e komisioneve

Kostoja vjetore për shpërblimin e anëtarëve të dy komisioneve përlllogaritet në 0,8 milionë lekë.

Komisioni i Përhershëm i Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit përbëhet nga 5 anëtarë. Për secilin anëtar parashikohen deri në 12 pagesa në vit, në masën 0,01 milionë lekë për pagesë. Efekti financiar vjetor për këtë komision përlllogaritet në 0,6 milionë lekë.

Komisioni për Shqyrtimin e Ankimimeve përbëhet gjithashtu nga 5 anëtarë. Për secilin anëtar parashikohen deri në 4 pagesa në vit, në masën 0,01 milionë lekë për pagesë. Efekti financiar maksimal për këtë komision përlllogaritet në 0,2 milionë lekë në vit.

Anëtarët e komisioneve janë pjesë e stafit ekzistues të Ministrisë dhe institucioneve të saj të varësisë. Angazhimi në komisione realizohet paralelisht me detyrat e tyre të zakonshme funksionale dhe përbën ngarkesë shtesë pune. Kjo ngarkesë përfshin shqyrtimin e dokumentacionit administrativ dhe teknik, verifikimin e përmbushjes së kriterëve ligjore, përgatitjen e materialeve dhe procesverbaleve, pjesëmarrjen në mbledhje, shqyrtimin e ankimeve dhe marrjen e vendimeve kolegjiale që sjellin pasoja juridike për subjektet.

Pjesëmarrja në këto komisione kërkon gjithashtu përgjegjësi të shtuar profesionale dhe administrative, pasi vendimmarrja lidhet me dhënien, rinovimin ose ndryshimin e lejeve të peshkimit dhe me shqyrtimin e ankimeve të operatorëve. Për këtë arsye, shpërblimi synon të kompensojë angazhimin dhe ngarkesën shtesë të stafit, përtej ushtrimit të detyrave të zakonshme funksionale.

Kostoja e përgjithshme prej 0,8 milionë lekësh në vit përbën nevojë të re financiare dhe do të planifikohet në PBA-në përkatëse, brenda programit buxhetor 04230 “Mbështetje për Peshkimin”. Efekti financiar parashikohet të fillojë pas vitit 2026, pas hyrjes në fuqi të ligjit dhe miratimit të akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e tij.

Për rrjedhojë, nga kostoja e drejtpërdrejtë vjetore prej 2,8 milionë lekësh, vlera prej 2 milionë lekësh do të përballohet brenda fondit ekzistues të pagave të DSHPA-së, ndërsa vlera prej 0,8 milionë lekësh do të planifikohet në PBA-në përkatëse.

3. Kostoja e shtrirjes së sistemit VMS

Sistemi VMS është funksional që prej vitit 2021 për anijet me gjatësi të përgjithshme të barabartë ose më të madhe se 12 metra.

Për anijet me gjatësi nga 9 deri në 11,99 metra parashikohet blerja, instalimi dhe integrimi i 35 pajisjeve VMS brenda vitit 2027, me mbështetjen e projektit përkatës. Kostoja e investimit vlerësohet në 40 000 euro. Me kursin e këmbimit 1 euro = 96,2 lekë, kjo kosto përlllogaritet në:
 $40\,000 \text{ euro} \times 96,2 \text{ lekë/euro} = 3,848 \text{ milionë lekë}.$

Kjo vlerë është përfshirë në analizën e ndikimit si kosto ekonomike e njëhershme, pasi investimi lidhet drejtpërdrejt me shtrirjen e sistemit të monitorimit elektronik të flotës. Duke konsideruar vitin 2026 si Vitin 1 dhe vitin 2027 si Vitin 2 të analizës, kostoja prej 3,848 milionë lekësh është pasqyruar në Vitin 2, në zërin “Kosto për grupet e tjera – një herë”, duke qenë se

blerja, instalimi dhe integrimi i pajisjeve do të realizohen me mbështetjen e projektit përkatës dhe jo drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit.

Për anijet me gjatësi më të vogël se 9 metra, shtrirja e sistemit VMS parashikohet të realizohet deri më 1 janar 2030. Fondi për këtë qëllim është parashikuar brenda tavanëve të miratuara të programit buxhetor 04230 “Mbështetje për Peshkimin”. Megjithatë, vlera përfundimtare nuk mund të detajohet në këtë fazë, pasi vijon procesi i anketimit dhe mbledhjes së të dhënave për këtë segment të flotës.

Numri i anijeve me gjatësi më të vogël se 9 metra ndryshon në mënyrë të vazhdueshme për shkak të regjistrimeve, çregjistrimeve dhe përditësimeve të tjera të regjistrit të flotës. Gjithashtu, ende nuk janë përfunduar specifikimet teknike dhe studimi i tregut për pajisjet, instalimin, integrimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Pas përfundimit të anketimit, përcaktimit të numrit të anijeve që do t’i nënshtrohen detyrimit dhe realizimit të studimit të tregut, do të detajohet kostoja përkatëse brenda tavanëve të miratuara të programit buxhetor. Për shkak se aktualisht nuk disponohet një vlerë e mbështetur në të dhëna, kjo kosto nuk është përfshirë në përllogaritjen monetare 10-vjeçare të RIA-s. Analiza do të përditësohet pas përcaktimit të vlerës përfundimtare.

Për Sistemin Automatik të Identifikimit (AIS) nuk parashikohen kosto financiare shtesë, pasi sistemi është aktualisht ekzistues dhe funksional. Projektligji nuk kërkon ngritjen e një sistemi të ri, blerjen apo instalimin e pajisjeve shtesë, por synon të qartësojë dhe të standardizojë detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat institucionale për përdorimin e të dhënave të gjeneruara nga AIS-i në funksion të monitorimit dhe kontrollit të aktivitetit të anijeve peshkuese.

Të dhënat e AIS-it do të përdoren nga strukturat përgjegjëse e cila është propzuar të formohet. Për rrjedhojë, zbatimi i dispozitave që lidhen me AIS-in do të realizohet nëpërmjet infrastrukturës dhe kapaciteteve ekzistuese, pa krijuar nevojë për fonde shtesë nga buxheti i shtetit.

4. Kostoja e sistemit REM

Për Sistemin e Monitorimit Elektronik në Distançë (REM) do të zbatohet fillimisht një projekt pilot në një anije peshkuese. Projekti do të shërbejë për përcaktimin e standardeve dhe specifikimeve teknike, mënyrës së integrit me sistemet ekzistuese, shtrirjes së zbatimit dhe kostove të nevojshme për implementimin e plotë.

Në këtë fazë nuk mund të përcaktohet kostoja e plotë e sistemit REM, pasi nuk janë përcaktuar ende numri i anijeve që do të përfshihen, lloji dhe numri i pajisjeve, mënyra e transmetimit dhe ruajtjes së të dhënave, si dhe kostot e instalimit, integrit, mirëmbajtjes dhe funksionimit.

Për këtë arsye, kostoja e REM-së nuk vlerësohet si zero, por evidentohet si kosto e ardhshme, ende e pakuantifikuar. Pas përfundimit të projektit pilot dhe studimit të fizibilitetit, efektet financiare do të përllogariten dhe do të parashikohen brenda tavanëve të programit buxhetor 04230 “Mbështetje për Peshkimin”.

Nevoja për trajnimin e stafit do të vlerësohet pas përfundimit të projektit pilot dhe përcaktimit të teknologjisë që do të përdoret. Numri i punonjësve që do të trajnohen, përmbytja e trajnimit dhe kostoja përkatëse do të përcaktohen përpara zbatimit të plotë të sistemit REM.

5. Kostot për sektorin privat

Për sektorin privat nuk parashikohen kosto monetare të drejtpërdrejta për blerjen, instalimin ose integrimin e sistemeve VMS dhe REM. Këto sisteme krijohen për rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë së aktivitetit të peshkimit, garantimin e zbatimit të barabartë të rregullave dhe parandalimin e peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar.

Operatorët do të kenë detyrimin të lejojnë instalimin e pajisjeve, t'i mbajnë ato funksionale, të mos i manipulojnë dhe të transmetojnë informacionin e kërkuar. Ata do të kenë gjithashtu detyrimin për transmetimin elektronik të librit të peshkimit, deklaratave të zbarkimit dhe transbordimit, si dhe për mbajtjen e regjistrave përkatës.

Mund të lindin vetëm kosto administrative të kufizuara për raportimin periodik, njohjen e procedurave të reja dhe përshtatjen e proceseve të brendshme. Këto kosto nuk mund të kuantifikohen aktualisht për shkak të mungesës së të dhënave në terren dhe të kërkesave përfundimtare teknike dhe procedurale.

Raporti i ndikimit të vlerësimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Status quo	0	0	0
Opsioni 3	23.61	0	-23.61

Megjithëse status quo-ja nuk krijon kosto financiare shtesë krahasuar me situatën aktuale, ruajtja e saj do të linte të patrajtuara mangësitë ekzistuese në monitorimin elektronik të flotës, kontrollin e aktivitetit të peshkimit, raportimin dhe shkëmbimin e të dhënave, si dhe gjurmueshmërinë e produkteve. Gjithashtu, ky opsion nuk do të mundësonte përafrimin e plotë të kuadrit ligjor kombëtar me kërkesat e reja të acquis të Bashkimit Evropian.

Opsioni 3, edhe pse rezulton me një vlerë aktuale neto negative prej **–23.61 milionë lekësh**, krijon përfitime të rëndësishme jomonetare. Këto lidhen me rritjen e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë së aktivitetit të peshkimit, standardizimin dhe digjitalizimin e procedurave, forcimin e monitorimit dhe kontrollit, përmirësimin e gjurmueshmërisë, kufizimin e peshkimit të paligjshëm, garantimin e konkurrencës së ndershme dhe përmirësimin e standardeve të tregtimit të produkteve të peshkimit. Për rrjedhojë, pavarësisht kostos financiare të identifikuar, Opsioni 3 vlerësohet si alternativa më efektive dhe e përshtatshme për realizimin e objektivave të projektligjit.